

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT

RAPORTI VJETOR

2 0 2 4

TIRANË, MARS 2025

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	3
2. Mesazhi	4
3. Kuadri ligjor	5
4. Respektimi dhe plotësimi i detyrimeve ndërkombëtare, përmbushja e rekomandimeve të “progresraportit” të BE-së për Shqipërinë	7
5. Zbatimi i Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit në vitin 2024”	8
6. Veprimtaria e Autoritetit për vitin 2024.....	13
6.1. Arkivi.....	13
6.2. Informimi.....	16
6.3. Verifikimi i figurave.....	13
6.4. Marrëdhëniet ndërinstitucionale në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur gjatë diktaturës.....	21
6.5. Hulumtimi shkencor dhe edukimi qytetar	23
6.6. Siguria dhe zhvillimi teknologjik	26
6.7. Bashkëpunimi ndërkombëtar	28
7. Objektivat e institucionit për vitin 2024.....	30
8. Synimet për të ardhmen (2025).....	Error! Bookmark not defined. 31
9. Detyrimet ligjore nga Autoriteti dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar	3232
10. Ndryshimet në kuadrin rregullator për vitin 2022 dhe efektet e tyre.....	333
11. Mbi Problematikat e ndeshura në veprimtarinë e autoritetit me qëllim gjetjen e rrugëve më efikase për zgjidhjen e tyre nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave	33
12. Nevojat për ndryshime ligjore.....	36
13. Organizimi i brendshëm i institucionit - Struktura dhe organika e Autoritetit.....	36
14. Te dhenat për të ardhurat dhe shpenzime	40
15. Kallezimet penale dhe proceset gjyqësore, ku institucioni ka qene pale ne proces	42

I. HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) është institucion i pavarur, organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë nga të cilët: 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Shqipërisë, 1 (një) anëtar i propozuar nga Këshilli i Ministrave, 1 (një) anëtar përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve politikë dhe 1 (një) anëtar i propozuar nga Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në muajin qershor 2022, Kuvendi i Shqipërisë zgjodhi me shumicë votash bordin e ri drejtues të Autoritetit. Kjo procedurë u ndërmor për shkak të përfundimit të mandatit të Bordit të parë të Autoritetit. Në bordin e ri u zgjodh Kryetarja në detyrë e këtij institucioni, znj. Gentiana Sula, anëtar i bordit z. Altin Hoxha, z. Albert Nikolla si propozim i Kryeministrit, z. Gjergj Marku u votua mes 3 kandidatëve nga shoqatat e ish-të përndjekurve politikë dhe z. Skënder Vrioni u votua si e vetmja kandidaturë nga organizatat e të drejtave të njeriut. Në muajin dhjetor 2022, Kuvendi i Shqipërisë rizgjodhi në krye të Autoritetit znj. Gentiana Sula. Në këtë mandat të dytë, në vitin 2024 Autoriteti ka në përbërjen e tij, anëtarët si më poshtë vijon:

Znj. Gentiana Sula – kryetare

Z. Albert Nikolla – anëtar

Z. Altin Hoxha – anëtar

Z. Gjergji Marku – anëtar

Z. Skënder Vrioni – anëtar.

Autoriteti është përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në to, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, të ndryshuar, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, të së vërtetës, të pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Raporti vjetor i punës për vitin 2024 është hartuar në ligjin organik nr. 45/2015, “*Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*”, i ndryshuar, aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, që normojnë dhe rregullojnë veprimtarinë funksionale të institucionit, si dhe në Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Kuvendit.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti ka zhvilluar 50 mbledhje dhe ka marrë 743 vendime, nga të cilat 742 vendime unanime dhe 1 (një) vendim me mendim kundër; janë nënshkruar 5 marrëveshje bashkëpunimi. Nëpërmjet një pune voluminoze me përgjegjësi maksimale kundrejt misionit të institucionit nëpërmjet takimeve periodike, Autoriteti ka realizuar me shumë sukses marrjen e këtyre vendimeve të rëndësishme me impakt në fushën e demokratizimit të shoqërisë, për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

II. MESAZHI

E kaluara nuk është thjesht një arkiv i së shkuarës, por një themel mbi të cilin ndërtohet e ardhmja. Trauma e regjimit komunist në Shqipëri (1944-1991) la pasojë të thella tek individët dhe shoqëria, duke lënë pas një trashëgimi të dhimbshme të persekutimeve, zhdukjeve të detyruara, ndëshkimeve politike dhe një propagande që synonte fshirjen e të vërtetës. Puna për të nxjerrë në dritë këtë të kaluar mbetet një sfidë, por edhe një detyrë morale dhe ligjore, në të cilën Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) është angazhuar me përkushtim.

Me këtë fokus, gjatë vitit 2024, AIDSSH ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në dokumentimin e të shkuarës, garantimin e transparencës institucionale dhe informimin e edukimin qytetar.

Në kuadër të modernizimit të qasjes ndaj arkivave, AIDSSH-ja ka vijuar me deklasifikimin dhe digjitalizimin masiv të dokumenteve, duke synuar **hapjen e plotë të arkivit ndaj studiuesve dhe publikut përmes platformave digjitale**. Kjo përpjekje përfshin edhe zhvillimin e **Mediatekës**, një platformë digjitale që do të shërbejë si qendër dokumentimi për studiuesit dhe qytetarët e interesuar për të kaluarën. Për të garantuar mbështetjen financiare të këtij projekti, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar kontakte me **organizata dhe partnerë ndërkombëtarë**, të cilët kanë shprehur interes për të mbështetur këtë iniciativë.

Deri më **31.12.2024** kanë hyrë në total në Autoritet **3701** kërkesa individuale dhe janë mbyllur **3547** ose **96%** e kërkesave individuale.

Një nga prioritetet kyçe të institucionit ka qenë **hetimi dhe dokumentimi i fatit të personave të zhdukur** gjatë diktaturës komuniste.

Gjatë këtij viti janë identifikuar **6 vendvarrime të reja**, duke e çuar në **11 numrin total të vendvarrimeve të konfirmuara** për periudhën 2022-2024. AIDSSH-ja ka vijuar bashkëpunimin me **Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP)** dhe ka ndërmarrë hapa për përfshirjen e të dhënave të identifikimit në **Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të Integruara (DMS)**, i cili përdoret globalisht për raste të zhdukjeve me forcë. Megjithatë, mungesa e një angazhimi të qartë nga institucionet përgjegjëse, veçanërisht nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë, ka ngadalësuar procesin e gërmimeve dhe të identifikimit të eshtrave. Për këtë arsye, Autoriteti ka përgatitur një **projekt vendim për përcaktimin e institucioneve përgjegjëse**, i cili mbetet ende në pritje të miratimit, i cili ka nevojë për mbështetjen e Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave.

Gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve edukative të grupuara si më poshtë:

- **Platforma “Mësojmë nga e Kaluara”**, e cila po zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Këshillin e Evropës, me qëllim integrimin e historisë së diktaturës në kurrikulat shkollore.
- **Botimi i librave edukativë**, si “Dielli lind në Spaç” dhe “Kufij të thyer”, të cilët tashmë janë miratuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe do të përdoren në shkolla gjatë vitit 2025.
- **Klubi i Librit “Mësojmë nga e Kaluara”**, ku mbi **346 pjesëmarrës** në qytete të ndryshme kanë diskutuar letërsi memuaristike mbi të kaluarën komuniste.

- **Simpoziume dhe ekspozita**, duke përfshirë simpoziumin për “Sabotatorët në Naftë dhe Ekonomi” dhe aktivitetin përkujtimor në Porto-Palermo.

Këto aktivitete synojnë të nxisin reflektimin kritik të rinjtë dhe të ruajnë kujtesën historike në një kohë kur përpjekjet për mohimin ose manipulimin e saj janë ende të pranishme.

Gjatë vitit 2024, AIDSSH-ja ka zgjeruar ndjeshëm praninë mediatike dhe angazhimin publik përmes 44 njoftimeve për shtyp, mbi 500 postimeve në rrjetet sociale dhe 10 intervistave në mediat kryesore. Fushatat e komunikimit kanë promovuar transparencën mbi dosjet e ish-Sigurimit, ndërgjegjësimin historik dhe aktivitetet institucionale. Rritja organike e ndjekësve dhe përfshirja e gjerë mediatike dëshmojnë interesin e shtuar për këtë tematikë, duke konfirmuar efektivitetin e strategjisë së komunikimit. Mediat kryesore në vend si : Top Channel, Vizion Plus, Klan Neës, Euroneës, Neës24, Reporter TV, RTSH, gazetat dhe portale e njohura, si Panorama, Shqiptarja.com, Gazeta Shqiptare, Ballkanëeb, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Tema, etj. kanë pasqyruar gjerësisht aktivitete të institucionit.

Në funksion të llogaridhënies publike dhe garantimit të pastërtisë së figurës së zyrtarëve, AIDSSH-ja ka vijuar procesin e verifikimit të figurave për individët që mbajnë ose synojnë poste publike. Gjatë vitit 2024 janë trajtuar **263 kërkesa për verifikim**.

Në të njëjtën kohë, Autoriteti ka vijuar me shqyrtimin e kërkesave për **emërtime rrugësh dhe hapësirash publike, si dhe dhënien e titujve të nderit**. Ndonëse Autoriteti ka komunikuar me të 61 bashkitë në vend, mbetet shqetësuese fakti se vetëm **26% e bashkive** kanë bashkëpunuar për këtë proces, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm i bashkive vazhdojnë të japin tituj dhe emërtime pa verifikimin përkatës.

Sfidat dhe objektivat për të ardhmen

Pavarësisht progresit të bërë, sfidat mbeten të shumta. Procesi i verifikimit të figurave dhe identifikimit të të zhdurve ende përballet me mungesën e bashkëpunimit të plotë nga disa institucione. Po ashtu, përpjekjet për përmirësimin e **kuadrit ligjor** për verifikimin e kandidatëve për zgjedhje dhe ndryshimet në **Kodin Zgjedhor** mbeten ende të papërbushura.

Në vitin 2025, AIDSSH-ja do të vijojë punën për të zgjeruar aksesin në arkivat historikë, për të thelluar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të siguruar që transparenca dhe drejtësia të mbeten në themel të punës sonë.

E shkuara nuk mund të ndryshohet, por të vërtetat e saj mund dhe duhet të zbulohen – si një domosdoshmëri për të ardhmen demokratike të Shqipërisë.

III. KUADRI LIGJOR

Gjatë vitit 2024, legjislacioni mbi të cilin mbështetet dhe organizohet puna e Autoritetit, nuk ka pësuar ndryshime.

Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara nga baza ligjore e mëposhtme:

Ligj nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Shërbimet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”; ligji nr. 7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë; ligji nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”; ligji nr. 124/024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar ne 2024; ligji nr. nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar me ligjin nr. 27, datë 04.04.2024 dhe nr. 99, datë 12.09.2024; Ligj nr. 119, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e Informimit”; ligj nr. 44/20151 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës Së Shqipërisë”;

si dhe në akte nënligjore si vijon: vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 95, datë 22.12.2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”; vendim i Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 15.02.2017 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritete të tjera publike”; vendim i Këshillit të Ministrave nr. 935, datë 28.12.2016 “Për kalimin nën përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të shtetit, të objektit nr. 52, me emërtim “Arkivi i Ri”, brenda territorit të pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes”, me vendndodhje lagjja nr. 10, Rruga e Dibrës, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, i ndryshuar, me anë të së cilës është përcaktuar mjedisi në të cilin AIDSSH do të ushtrojë veprimtarinë e vet; vendimi nr. 93, datë 27.02.2020, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;

Akte rregullatore të brendshme të Autoritetit: rregullore e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit (version i rishikuar); Rregullore “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 13, datë 14.04.2017; rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”, miratuar me vendimin nr. 25, datë 25.05.2017, të Autoritetit; rregullore “Mbi publikimin e veprimtarisë së Autoritetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj, përmes buletinit në letër apo online në faqen e Autoritetit”; vendimi nr. 97, dt. 12.02.2024, "Për miratimin e propozimeve ligjore "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 538, datë 07.10.2020 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 'Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit"; vendimi nr. 177, datë 04.04.2024, "Për miratimin e udhëzuesit 'Për rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person dhe formularit të aplikimit".

IV. RESPEKTIMI DHE PLOTËSIMI I DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

Në kuadër të angazhimit për plotësimin e detyrimeve në plan ndërkombëtar, AIDSSH-ja ka dhënë kontribut përmes shkresës nr. 111 prot. datë 25.03.02 drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për raportin kombëtar për Konventën për Zbatimin e Konventës për Mbrojtjen nga Zhdukja e Detyruar për periudhën raportuese 2018-2024.

Qëllimi i raportit ishte evidentimi i hapave të ndërmarrë nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist, në kuadër të rekomandimeve ndërkombëtare dhe detyrimeve ligjore.

-Përmirësimi i kuadrit ligjor

- Ndryshimet në ligjin nr. 45/2015 me ligjin nr. 72/2022 i dhanë AIDSSH-së kompetenca për verifikime administrative mbi çështjen e të zhdukurve.
- Ligji nr. 83/2018 ratifikoi Marrëveshjen me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), duke ngritur një zyrë të dedikuar në Shqipëri.
- Me ligjin nr. 114/2020 u shtua neni 22/1, që formalizoi bashkëpunimin për identifikimin dhe mbrojtjen e vendvarrimeve.

-Zhvillimi i strukturave dhe proceseve institucionale

- Krijimi i Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërinstitucionale për Personat e Zhdukur brenda AIDSSH-së.
- Hartimi i një metodologjie standarde për verifikimin e rrethanave të zhdukjes.
- Krijimi i një regjistri të dhënave mbi personat e zhdukur dhe një harte të vendvarrimeve të dyshuara.

-Rezultatet kryesore (2018-2024)

- **280 kërkesa** nga familjarët e personave të zhdukur janë trajtuar.
- Janë identifikuar **vende të dyshuara varrimi**, si Burgu i Burrelit, Burgu i Gjirokastrës, Burgu i Shkodrës dhe Kampi i Tepelenës.
- Janë mbledhur **dëshmi dhe dokumente historike**, duke hedhur dritë mbi fatin e disa personave të zhdukur.
- Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me **ICMP dhe Policinë e Shtetit** për mbështetje teknike dhe shkëmbim informacioni.

-Bashkëpunimi ndërinstitucional

- Hartimi i një VKM-je për qartësimin e përgjegjësiave institucionale mbi procesin e kërkimit dhe identifikimit të zhdukurve.
- Takime të rregullta me institucione si **Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe OSBE** për të koordinuar përpjekjet.
- Krijimi i një **marrëveshjeje trepalëshe** mes Ministrisë së Brendshme, ICMP dhe AIDSSH për thellimin e bashkëpunimit.

AIDSSH-ja ka luajtur një rol kyç në avancimin e procesit të kërkimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur gjatë komunizmit. Përmes forcimit të kuadrit ligjor, strukturave institucionale dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, është hedhur baza për një proces më të sistemuar dhe efektiv në zbardhjen e këtyre ngjarjeve historike.

Ky angazhim konfirmon gatishmërinë e Autoritetit për të vijuar në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme marrëdhëniet me aktorët ndërkombëtarë, në funksion të transparencës, dokumentimit historik dhe ndarjes së praktikave të mira.

V. ZBATIMI I REZOLUTËS SË KUVENDIT PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT NË VITIN 2024

a. Rekomandim: “Të vijojë angazhimin për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e ngarkuara për këtë qëllim.”

Në përmbushje të rekomandimit si më sipër, janë ndërmarrë këto iniciativa:

a.1 Bashkëpunim ndërinstitutional dhe kuadër ligjor

- Është realizuar projektvendimi i Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar. Autoriteti ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e projektvendimit “Për përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara, të personave të zhdukur në këtë periudhë”, që do të mundësojë përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse dhe mekanizmave institucionale për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur ose ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit, si dhe garantimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të tyre. Ky projektvendim është hartuar në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Tiranë dhe është rezultat i një bashkëveprimi ndërinstitutional ndërmjet Autoritetit, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Brendshme, ICMP-së, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Institutit të Policisë Shkencore.

Përmes kësaj VKM-je synohet të arrihet:

- Identifikimi dhe rikuperimi i eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar në periudhën nga 29 nëntor 1944 deri në 2 korrik 1991;
- Sigurimi i mënyrave të përshtatshme për ruajtjen e vendvarrimeve të identifikuara apo dyshuara të personave të zhdukur ose ekzekutuar;
- Përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve përfshirëse në këtë proces; vendosja e modaliteteve të bashkëpunimit mes institucioneve për të siguruar një përgjigje efikase dhe të koordinuar në zbatimin e VKM-së.

-Përmirësimi i bashkëpunimit me organet tjera për të garantuar zbatimin e VKM-së dhe për të adresuar nevojat dhe interesat e të prekurve nga kjo çështje në mënyrë efikase.

Është intensifikuar bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, ICMP-në , Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, si dhe me organet e pushtetit lokal. Projektvendimi është përcjellë në datë 12.06.2024 për mendim dhe miratim në Ministrinë e Drejtësisë së bashku me relacionin shoqërues. Ministria e Drejtësisë ia ka përcjellë për kompetencë Ministrisë së Brendshme.

- Është nënshkruar në Maj 2024 marrëveshja e bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) titulluar “Protokoll mbi marrëveshjet praktike lidhur me koordinimin në zbatim të projektit ‘Mbështetja e Drejtësisë Tranzicionale dhe trajtimi i së Shkuarës në Shqipëri’”. Qëllimi i këtij protokoll është përcaktimi i modaliteteve të koordinimit midis AIDSH-së dhe ICMP-së

për zbatimin e projektit 24-mujor “Mbështetja e Drejtësisë Tranzicionale dhe trajtimi i së Shkuarës në Shqipëri”.

a.2. Kryerje verifikimesh administrative për identifikimin e vendvarrimeve të dyshuara

Aktualisht 6 hetime administrative janë në proces, nga të cilat 3 hetime iniciuar në vitin 2023 dhe 3 në vitin 2024. Është nisur verifikimi administrativ, për gjetjen e personave pjesë e “Grupit të sabotatorëve në naftë dhe ekonomi” të ekzekutuar gjatë regjimit komunist.

Gjatë vitit 2024 janë evidentuar 6 (gjashtë) vendvarrime të personave të zhdukur nga ish-regjimi komunist. Drejtoria përkatëse ka monitoruar vendvarrimet e identifikuar dhe të dyshuara të personave të zhdukur që mos të tjetërsohen si territore, e mos të ndërhyhet në to për asnjë lloj arsye. Po ashtu, janë vendosur tabelat në 6 vendvarrime.

a.3 Administrimi i kërkesave të depozituara nga familjarët apo palë të treta të interesuara për gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Në këtë kuadër, janë realizuar intervista dhe takime me këta familjarë apo persona në dijeni për personat e zhdukur.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2024, nga familjarë dhe të afërm të personave të zhdukur janë paraqitur **59 kërkesa** sipas *formularit tip* të miratuar nga Autoriteti. Përsa i përket aspektit gjinor, **20 prej kërkueseve/aplikueseve janë gra**. Janë realizuar **5 dëshmi/intervista** nga/me familjarë dhe të afërm të personave të zhdukur.

b. Rekomandim “Të vijojë angazhimin për krijimin e një baze të vetme të dhënash për personat e zhdukur dhe ta bëjë atë publike e të aksesueshme për publikun.”.

Në përmbushje të rekomandimit si më sipër, janë ndërmarrë këto iniciativa:

- Sistemi i menaxhimit të të dhënave identifikuese (IDMS).

Drejtoria ka përditësuar databazën me të dhënat e detajuara për personat e zhdukur (gjeneralitete, nr. kontakti, adresë banimi, etj.). Në bashkëpunim me ICMP-në, po punohet për trajnimin e stafit të Drejtorisë në lidhje me përdorimin e platformës ndërkombëtare “Sistemi i Menaxhimit të Dhënave të Integruara” (DMS), e cila përdoret sot nga shumica e shteteve që kanë problematika lidhur me personat e zhdukur.

Trajnimi është kryer nga nivelet “operator” deri “administrator” të platformës, ndërsa lektorët (trajnuesit) janë krijues dhe njohës të platformës. Për këtë qëllim, në muajin nëntor 2024 kanë vizituar Autoritetin, z. Adnan Rizviç, Drejtor i Përgjithshëm i IDMS-së, dhe znj. Samira Krehiç, Zv. Shefe e Programit të ICMP për Ballkanin Perëndimor.

c. Rekomandim: “Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie nga komisionet ‘Bezhani’ e ‘Mezini’.”

Identifikimi i institucioneve dhe zyrtarëve, gjatë viteve 2017-2022, në të cilat vendimmarrja e Autoritetit lidhet me kandidatë për të cilët nuk është kryer procedura verifikuese pasi kandidatët dispononin dokumentin autentik original (ose kopje) të certifikatës së pastërtisë së figurës.

Janë identifikuar gjithsej 13 zyrtarë në 6 institucione, për të cilët nga Autoriteti nuk është kryer verifikimi.

Bashkëpunimi me institucionet

Autoriteti u është drejtuar me shkresë të gjitha institucioneve, me qëllim që lidhur me vendimmarrjet e mëparshme, t'i drejtohen Autoritetit me kërkesë për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie të figurës të komisioneve “Mezini” dhe “Bezhani”.

Në referencë të shkresave të dërguara dhe të dhënave informale rezulton se 7 zyrtarë nuk janë më në detyra shtetërore (1 zyrtar për shkak të mbarimit të mandatit, 1 zyrtar për shkak të moshës së pensionit, 5 zyrtarë nuk janë më në detyrë), 3 zyrtarë janë në detyra shtetërore, por 2 prej tyre nuk janë më subjekte verifikimi sipas ligjit për shkak të pozicionit aktual, ndërsa për 3 zyrtarë nuk ka ende informacion nga institucioni përkatës.

d. Rekomandim: “Të bashkëpunojë me KQZ-në për ndryshimet e nevojshme të kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, Kodit Zgjedhor, apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të angazhohet për verifikimin e të gjithë kandidatëve në zgjedhje.”

Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës të kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ka nevojë të disiplinohet në dispozita të veçanta të Kodit Zgjedhor.

Propozime për Kodin Zgjedhor

Autoriteti ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë shkresa zyrtare për propozime konkrete për ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat nuk u morën parasysh.

Ndryshime ligjore nevojiten edhe në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, si edhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar.

Propozime në lidhje me ligjin për partitë politike

Me shkresë zyrtare është kërkuar bashkëpunim edhe me Komisionerin Shtetëror për Zgjedhjet për problematikat e hasura për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga ana e partive politike apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhjet parlamentare apo vendore, si edhe për plotësimin e detyrës së ngarkuar nga pika 4 e Rezolutës.

e. Rekomandim: “Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve arkivore sipas përkufizimit të nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, si dhe t'i raportojë Kuvendit për të adresuar problematikat e hasura gjatë procesit.”

Në lidhje me grumbullimin e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e Arkivit ka intensifikuar korrespondencat zyrtare, takimet zyrtare, rishikimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale, si

dhe hartimin e draft-urdhreve të rinj. Si rezultat, është firmosur urdhri i përbashkët nr. 564, datë 11.10.2024, midis DPA-së dhe AIDSSH-së, për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin, vlerësimin dhe dorëzimin e dokumenteve arkivore mbi ish-Sigurimin e Shtetit, që ndodhen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Po kështu, nëpërmjet procesit të grumbullimit gjatë vitit 2024, janë marrë në dorëzim dhe janë sistemuar në 72 kuti, në total 3 244 njësi arkivore me 55 289 fletë dhe 5 732 kartela.

f. Rekomandim: “Të angazhohet në përmirësimin e procedurave për ta bërë procesin e verifikimit të subjekteve lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm, si dhe të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit.”

Në përmbushje të rekomandimit si më sipër, janë ndërmarrë këto aktivitete:

1. Kërkimi i mundësive të reja të bashkëpunimit, dërgimi i kërkesave për bashkëpunim në mënyra që të njihet më shumë roli, rëndësia dhe nevoja e kryerjes së aktivitetit të Autoritetit.
2. Përditësimi i databazës së informacionit mbi kërkesat e institucioneve, emrat e zyrtarëve, rezultatit e verifikimit për secilin, numri i personave që rezultojnë me të dhëna, apo si figuron zyrtari, kryhet vazhdimisht. Për publikimin e plotë të të dhënave (të databazës me çdo të dhënë) nevojiten ndryshime ligjore në ligjin nr. 45/2015 për të mundësuar publikimin e tyre në përputhje me standarde ndërkombëtare, pa harruar edhe përvojën e institucioneve homologe. Rrjetit Evropian të Autoriteteve Përgjegjëse për Dosjet e Policisë Sekrete, si institucione me përvojë të gjatë në këtë drejtim, i është kërkuar bashkëpunim lidhur me strategjitë dhe politikat e ndjekura për mbrojtjen e të dhënave personale për kandidatët që emërohen apo zgjidhen në poste të larta publike.

g. Rekomandim: “Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues përmes përdorimit të mediave dhe formave të komunikimit virtual me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin mbi rolin e AIDSSH-së për informimin e individëve, mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.”

Gjatë vitit 2024, AIDSSH-ja ka zgjeruar ndjeshëm praninë e saj mediatike dhe angazhimin me publikun. Përmes strategjive të komunikimit dhe mbulimit të aktiviteteve të saj, institucionit i është mundësuar një shtrirje e gjerë e informacionit mbi dosjet e ish-Sigurimit, përballjen me dezinformimin dhe rritjen e transparencës. Rritja organike e ndjekësve dhe angazhimit të publikut tregon efektivitetin e strategjive të komunikimit dhe interesin e vazhdueshëm për këtë tematikë.

Përmbledhje e aktivitetit mediatik

1. Njoftimet për shtyp, web dhe media sociale

- **Numri i njoftimeve për shtyp:** 44 njoftime (tekst, figurë, video)
- **Postime në rrjetet sociale:**
 - **Facebook:** 324 postime (tekst, foto, video, story, reels)
 - **Instagram:** 145 postime (video, tekst, foto)
 - **TikTok:** [Pa numër specifik]
 - **X (Twitter):** 20 postime

Tematikat kryesore të trajtuara

- Fushata e komunikimit në rrjetet zyrtare (Facebook, Instagram, TikTok, X, YouTube, dhe faqja e internetit eëë.autoritetidosjeve.gov.al) ka promovuar:
 - Aktivitetin në ndërgjegjësimin për zbardhjen dhe njohjen e së shkuarës.
 - Qasjen e individëve, zyrtarëve, studiuesve dhe medias në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
 - Konferencat dhe simpoziumet.
 - Kthimin në vendkujtesë dhe gjetjet nga vendvarrimet e dyshuara.
 - Ekspozitat arkivore mbi:
 - Shkelësit e kufirit.
 - Persekutimin e inxhinierëve të naftës.
 - Dëshmitë dhe ekspozitën për personat e internuar në kalanë e Porto-Palermos.
 - Edukimin qytetar përmes videove, figurave dhe materialeve audio nga aktivitetet edukative, si:
 - **AIDSSH – Klubi i Librit dhe Libri për Fëmijë** (43 postime në Facebook).

2. Përgatitja për intervistat e Kryetares

- **Numri i intervistave të organizuara:** 10 intervista (Klan, Vizion Plus, Klan Neës, Euroneës, Neës24, Reporter TV, Top Channel, RTSH).
- **Pikat kyçe të mesazhit:**
 - Rëndësia e aksesit në dosjet e ish-Sigurimit.
 - Projektet kryesore të institucionit.
 - Përballja me dezinformimin.
- **Menaxhimi i teksteve për mediat sociale:** Përgatitur dhe menaxhuar nga zëdhënësja e Autoritetit.

3. Shtrirja mediatike

- **Numri i mediave që kanë pasqyruar aktivitetet e AIDSSH:** Mbi 20 media.
- **Shtypi i shkruar:** Mbi 10 artikuj të botuar në revistat kryesore (Panorama, NeësBomb, Gazeta Shqiptare).
- **Kategoritë e mediave të përfshira:** Televizione kombëtare, portale kryesore.
- **Analiza mbi mbulimin pas çdo aktiviteti:** Përmes raportimeve dhe vlerësimeve të ndikimit mediatik.
- **Klubi i Gazetarëve të Autoritetit:** Aktivitet i posaçëm për rritjen e bashkëpunimit me median.

Statistikat e rrjeteve sociale

Facebook

- 5.5K ndjekës, me rritje organike të trafikut.
- Shtrirja e audiencës: 90,560 shikues.
- Angazhimi: 22,727 persona (rritje prej 84.2% në 80 ditët e fundit).

- 76.3% ndjekës të faqes, 22.7% jondjekës.

Instagram

- Rritje prej 1500 ndjekësish të rinj (gjithsej 1991 ndjekës).
- Rritje organike, pa financim.

Autoriteti synon të thellojë këto përpjekje gjatë vitit 2025 përmes zhvillimit të një platforme të re digjitale (MEDIATEKA) e cila do të bëhet funksionale brenda vitit 2025, rritjes së aksesit në dokumente dhe zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimeve me media dhe institucione arsimore.

j. “Të angazhohet për një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor me qëllim zbatimin korrekt të ligjit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi, apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh, trajtimin e vendvarrimeve të dyshuara të ekzekutimeve, varreve të pashënuara, trajtimin e vendeve të kujtesës, strukturat e arsimit, bibliotekat e muzetë lokale.”

- Në maj të vitit 2024, u ngrit grupi i punës për hartimin e “Punës përgatitore për hartimin e një udhëzuesi për modalitetet e punës me strukturat e pushtetit vendor përgjegjëse për verifikimin e figurës së kandidatëve të propozuar për dekorata, tituj nderi, emra rrugësh, hapësirash publike, trajtimin e vendvarrimeve të dyshuara të ekzekutimeve, varreve të pashënuara, trajtimin e vendeve të kujtesës, strukturat e arsimit, bibliotekat e muzetë lokal”.

- Grupi i punës identifikoi kuadrin ligjor dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve ligjore. Janë identifikuar dhe paraqitur disa propozime konkrete për bashkëpunim me këto struktura.

- *U hartua draft-udhëzuesi.*
- U organizua takim zyrtar me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor lidhur me draft-udhëzuesin.
- U bashkëpunua për këtë proces me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

VI. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT PËR VITIN 2024

VI.1 ARKIVI


Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti ka vijuar punën për mbledhjen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit.

Objektivat:


Deklasifikim masiv të dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror” në kuadër të objektivit final: hapjes totale të dokumenteve të ish-sigurimit ndaj publikut;

VITI	Njësi arkivore (dosje, fashiku)	Fletë arkivore
2022	769	74 579
2023	5591	237 259
2024	17 303	1 096 699
TOTALI	23 663	1 408 537

Deklasifikime janar 2023 - dhjetor 2023



Deklasifikime Janar 2024 - Dhjetor 2024



Digjitalizim masiv i dokumenteve arkivore në kuadër të popullimit të arkivit digjital

Procesi i skanimit/digjitalizimit është një proces tjetër që realizohet në kuadër të shërbimit të dokumenteve arkivore. Autoriteti ka miratuar udhëzimin "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen në arkivin e AIDSSH-së, mënyrën e përdorimit dhe shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor", miratuar me vendim 201, datë 21.05.2022 për të rregulluar këtë proces.

Për të avancuar në këtë proces, institucioni, prej muajit nëntor 2023 e për gjatë gjithë vitit 2024, paralelisht me digjitalizimin rast pas rasti në funksion të trajtimit të kërkesave nga Sektori i Digjitalizimit dhe Fotokopjes, kryen edhe skanim masiv me operator ekonomik privat.

Më poshtë, një pasqyrë me të dhëna mbi digjitalizimin që prej vitit 2017.

VITI	DOSJE FIZIKE	MIKROFILM	DOKUMENTE/IMAZHE/SDF	DOKUMENTE/IMAZHE /OPERATORI EKONOMIK I Kontraktuar
2017	140	0	30,000	
2018	118	0	119,928	
2019	904	452	216,000	
2020	154	57	120,478	
2021	610	196	101,294	
2022	1,019	175	155,844	
2023	2,105	0	152,046	1,381,418
2024 (Janar- Dhjetor)	646	0	46,772	1,420,096
GJITHSEJ	Rreth 5,696 dosje fizike	Rreth 880 dosje mikrofilm	Rreth 942,362 mazhe	Total 2,801,514 imazhe
Totali i dokumenteve/ imazheve të skanuara në Autoritet për periudhën 2017- 2024 (SDF + Operatore të kontraktuar)				3,743,876 /imazhe

Intensifikim i bashkëpunimit me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve arkivore, me synim pasurimin e arkivit, dhe për të garantuar një kërkim sa më shterues në funksion të kërkesave të qytetarëve/subjekteve.

Në lidhje me grumbullimin e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e Arkivit ka intensifikuar korrespondencat zyrtare, takimet zyrtare, rishikimin e marrëveshjeve ndër-institucionale si dhe hartimin e draft-urdhreve të rinj. Si rezultat, është firmosur urdhri i përbashkët nr. 564, datë 11.10.2024, midis DPA dhe AIDSSH, për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin, vlerësimin dhe dorëzimin e dokumenteve arkivore mbi ish-Sigurimin të Shtetit, që ndodhen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave tek AIDSSH.

Po kështu, nëpërmjet procesit të grumbullimit gjatë vitit 2024, janë marrë në dorëzim dhe janë sistemuar në **72** kuti, në total **3 244** njësi arkivore me **55 289 fletë dhe 5 732 kartela**.

Një nga funksionet e Drejtorisë së Arkivit është edhe *trajtimi i kërkesave* të ndryshme të ardhura në Autoritet nga palët e interesuara, duke identifikuar, evidentuar dhe kthyer përgjigje sipas tipologjive përkatëse. Ky proces ofron një informacioni të plotë për të mbështetur kërkesat dhe për të siguruar transparencën dhe saktësinë e të dhënave.

Indikatorët e punës në këtë aspekt raportohen më poshtë në raport, ku paraqiten të dhëna mbi kërkesat sipas kategorive: Kërkesa individuale për informim të palëve të prekura dhe të treta, kërkesa për qëllim rehabilitimi, kërkesa studimore/mediatike, kërkesa për qartësimin e fatit të personave të zhdukur dhe kërkesa institucionale.

Objektivi i Drejtorisë së Arkivit është që të procesin e kërimit t`a bëjë sa më efikas në kohë dhe në rezultat. Këtij qëllimi i shërben edhe Projekti i Kartotekës, i cili mundëson aplikimin e mjeteve të reja të kërimit në procesin e trajtimit të kërkesave. Në 2024 u prokuruan dhe instaluan 45 rafte, të cilat u sistemuan në sallën e Kartotekës dhe u etiketuan në mënyrë alfabetike, duke nisur menjëherë procesi i renditjes fizike të 44 179 kartelave *model 1* ku çdo kartelë u vendos në ndarjen përkatëse. Të dhënat e këtyre kartelave u indeksuan dhe u renditën në mënyrë digjitale, dhe në total u regjistruan 204 532 të dhëna, të cilat tashmë shërbejnë si mjete të reja kërkimi.

Në vijim, u indeksuan dhe u renditën në mënyrë digjitale 151120 emra nga regjistrat *model 1*, në total u regjistruan 1 662 320 të dhëna arkivore, të cilat shërbejnë si mjete të reja kërkimi. Po kështu, pas inventarizimit dhe përpunimit të fondit arkivor të KQ të PPSH-së, u krijua inventari elektronik i 1 199 njësive arkivore, i cili shfrytëzohet edhe si mjet i ri kërkimi.

Ruajtja dhe mirëmbajtja e materialeve arkivore të grumbulluara duke garantuar se dokumentet nuk do të lexohen, të kopjohen, të ndryshohen, të asgjësohen apo të largohen pa autorizim, si një nga detyrat kryesore funksionale të Autoritetit.

Kjo detyrë është ndjekur dhe zbatuar në të gjitha ambientet ku ruhen dhe administrohen dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të marra në dorëzim nga Autoriteti. Që prej vitit 2022 i gjithë dokumentacioni arkivor që administrohet nga Autoriteti, ruhet në ambiente të sigurta dhe sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin për Arkivat.

VI.2 INFORMIMI I INDIVIDËVE DHE QYTETARËVE

Ndërmjet të tjerash, objekti dhe qëllimi kryesor i veprimtarisë së Autoritetit është të sigurojë të drejtën e çdo qytetari për të parë informacionin e krijuar ose të mbledhur rreth tyre nga ish-Sigurimi i Shtetit. Ofrimi i aksesit në këto dokumente, bazuar lejimeve dhe kufizimeve ligjore, mbetet prioritet i Autoritetit.

VI.2.1 Kërkesat individuale nga palë të prekura

Në periudhën 12 mujore Janar – Dhjetor 2024:

- Kanë hyrë në Autoritet **503** kërkesa individuale ose 46 kërkesa më shumë se gjatë 2023;
- Janë mbyllur **535** kërkesa ose 5% më shumë se viti 2023, nga të cilat:
 -  362 kërkesa të hyra në 2024,
 -  49 i përkasin periudhës 2018-2022
 -  124 vitit 2023


Të shprehur në përqindje:

- 9.1 % - janë kërkesa të viteve 2018-2022 – zbardhje bashkëpunëtorësh;
- 23.2% - janë kërkesa të 2023;

67.7% - janë kërkesa të 2024.

Statistika mbi rezultatet e përpunimit të kërkesave 2023-2024

	Hyrë	mbledhje	legjitimuar		mbyllur		vendime		zbardhje		me dok arkivor	pa dok arkivor
				2018-2022	2023	2024		2018-2022	2023	2024		
2024	503	38	482	49	124	362	493	36	15	11	232	210
2023	457	43	432	18	161	330	471	10			277	187



Përpunimi dhe anonimizimi i dokumenteve

2022: Përpunuar **72 000** faqe, prej të cilave **24 000** të anonimizuara.

2023: Përpunuar **98 214** faqe, prej të cilave **27 000** të anonimizuara.

2024: Përpunuar **80 474** faqe, prej të cilave **27 248** të anonimizuara.

Deri më **31.12.2024** kanë hyrë në total në Autoritet **3701** kërkesa individuale dhe janë mbyllur **3547** ose **96%** e kërkesave individuale.

Deri më 31.12.2024 janë mbyllur 127 kërkesa për zbardhje bashkëpunëtorësh nga 148 të hyra (86%). Kërkuar për zbardhje rreth **1671** pseudonime dhe gjetur mbi **616** deri më tani.

Koha për mbylljen e një praktike me të dhëna që nga momenti i regjistrimit e deri në momentin e shprehjes me vendim është maksimumi **6 deri në 7 muaj** (përveç praktikave voluminoze mbi 1000 faqe, pasi koha maksimale është 8 deri në 9 muaj).

Koha e përgatitjes së draft-vendimit nga specialisti është 2 muaj deri në 6 muaj (përveç praktikave voluminoze mbi 1000 faqe, pasi koha maksimale është 6-8 muaj).

Koha për mbylljen e një praktike pa të dhëna që nga momenti i regjistrimit e deri në momentin e shprehjes me vendim, është 2 muaj.

VI.2.2 Trajtimi i Kërkesave të Qytetarëve dhe Shërbimeve Rehabilituese

- 216 kërkesa të hyra dhe të trajtuara për vitin 2024 nga të cilat:

- 208 për dokumentimin e internim/burgim për efekt pensioni (56 burgje ose 26.92%, 152 internime ose 73.08%); 95 pa të dhëna arkivore (54.6%);
- 8 kërkesa “për çdo person” sipas nenit 20, pika 1.1, nga të cilat 1 me të dhëna;
- 159 nga individë (76.44%), 49 nga ISSH (23.56%);
- 981 faqe dokumentacioni të trajtuara dhe 4 dëshmi të mbledhura nga të internuar pa të dhëna arkivore.

VI.2.3 Mediateka (platforma online e arkivit të ish-Sigurimit të Shtetit) është një iniciativë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në kuadër të objektivave të Strategjisë 2023-2028. Qëllimi i saj është promovimi i materialeve arkivore dhe dokumenteve historike për të lehtësuar studimin dhe informimin mbi periudhën e diktaturës në Shqipëri. Mediateka do të jetë një platformë digjitale e cila do të shërbejë si burim referimi për studiuesit, qytetarët dhe institucionet e interesuara për të kaluarën.

Realizuar deri në fund të vitit 2024:

- Ngritur grupi i punës për hartimin dhe zbatimin e projektit.
- Miratuar kalendari i datave të kujtesës, duke përcaktuar ngjarjet historike kryesore për përkujtim dhe dokumentim.
- Studiuar dhe analizuar rreth 30 dosje arkivore, duke përfshirë rregullore, udhëzime dhe urdhra të Ministrisë së Brendshme të periudhës 1944-1991.
- Përpunuar dhe filtruar informacioni për përfshirje në arkivën digjitale.

Mediateka do të shërbejë si një qendër e dokumentimit historik dhe një mjet i rëndësishëm për edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi të kaluarën komuniste të Shqipërisë. Në vitin 2025 pritet funksionalizimi i kësaj platforme me dokumentacion të gatshëm për t’u konsultuar nga publiku i gjerë.

VI.3 VERIFIKIMI I FIGURAVE

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve institucionale për vitin 2024, Drejtoria e Verifikimit të Figurave ka vijuar me realizimin e objektivave strategjikë dhe operacionalë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH). Më poshtë pasqyrohet progresi në përmirësimin e procedurave të verifikimit, lehtësimin e aksesit për institucionet kërkuuese dhe adresimin e kërkesave për verifikimin e figurave historike dhe funksionarëve publikë. Përmes analizës së të dhënave dhe përpunimit të dokumenteve arkivore, është siguruar një proces transparent dhe i besueshëm, duke përmbushur kërkesat ligjore dhe nevojat e institucioneve shtetërore e publike. Konkretisht, gjatë vitit 2024 ka vijuar puna për përmbushjen e objektivave të Autoritetit sidomos në kuadër të krijimit të lehtësirave në procedurat për institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike që kërkojnë informacion për:

- Verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për t’u zgjedhur ose emëruar në detyra publike.
- Verifikimin dhe informimin e autoriteteve publike në kuadër të propozimeve për dhënien e titujve të nderit dekorimit të shtetasve dhe të emërimit të hapësirave publike me emra personalitetesh, kërkesa të paraqitura nga të gjitha institucionet dhe autoritetet publike e sidomos atyre të paraqitura nga Pushteti Vendor duke pasur në fokus edhe hartimin e një dokumenti shpjegues udhëzuesi “Për modalitetet e punës me pushtetin vendor lidhur me emërtimin e rrugëve dhe hapësirave publike”.

- Përbushjen në kohë dhe cilësi e detyrave funksionale dhe ndihmëse, në funksion të nevojave dhe prioriteteve.
- Verifikimin e figurave historike/ figurës së personave mbajtës të funksioneve politike e të aparatit shtetëror të kohës, duke analizuar dhe argumentuar rolin, kontributin dhe veprimtarinë e ushtruar nga secili prej tyre, në bashkëpunim me grupin e punës ngritur për këtë qëllim sipas detyrave të ngarkuara për çdo verifikim të kryer.

Në total për periudhën Janar – Dhjetor 2024, në Autoritet janë paraqitur 82 kërkesa për verifikimin e 263 kandidatëve, janë verifikuar 251 kandidatë nga të cilët vetëm për 25 kandidat rezultojnë dokumente, pra figurojnë në dokumente të ish-sigurimit të shtetit si bashkëpunëtorë të ish Sigurimit të Shtetit, si ndihmës gjyqtarë, hetues dhe dëshmitar në procese politike dhe nga Autoriteti janë marrë 92 vendime.

Janë shqyrtuar në funksion të mbylljes së procedurës për kandidatët gjetjet arkivore, gjithsej 75 774 faqe dokumentesh të digjitalizuara apo fizike. Gjithashtu, për arritjen e përfundimeve sa më të sakta është studiuar edhe referenca apo kuadri ligjor i periudhës së veprimtarisë.


Në raport me vitin 2023, ka ulje në numrin e kërkesave institucionale 82 nga 124 në vitin 2023, por ka rritje në numrin e kandidatëve për verifikim: 263 kandidatë nga 232 kandidatë në vitin 2023. Numri i kandidatëve të verifikuar është afërsisht në të njëjtat nivele në të dy vitet: 251 nga 257 kandidatë. Rritje ka gjithashtu edhe në numrin e shtetasve që figurojnë me dokumente: 25 nga 14 të tillë në vitin 2023.


Raporti statistikor krahasues me vitin 2023

Kandidatë për verifikim në raport me vitin 2023




Kandidatë të verifikuar në raport me vitin 2023





Nga 82 kërkesa të reja të paraqitura dhe të legjitimuara në Autoritet, 43 prej tyre i përkasin 16 bashkive të cilat i janë drejtuar Autoritetit pas shkresës për bashkëpunim dërguar të 61 bashkive në fillim të vitit 2024.

Nga 263 kandidatë për verifikim, 157 janë shtetas për të cilët kërkesa është paraqitur nga bashkitë në kuadër të emërimit të rrugëve dhe shesheve hapësirave publike me emërtime ose për dhënie tituj nderi.



Nga 92 vendime të miratuara nga Autoriteti, 56 prej tyre i përkasin bashkive. Nga 25 kandidatë të propozuar për emërim rrugësh, hapësirash apo dekorim/dhënie titulli, 24 prej tyre i përkasin procedurave verifikuese sipas objektit të kërkesave të bashkive duke rezultuar në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, si bashkëpunëtor, si denoncues, si dëshmitar i akuzës, si hetues apo si anëtar të trupave gjykuese.

Përveç kërkesave të pushtetit vendor për verifikim të kandidatëve për emërimin e hapësirave të territorit publik dhe tituj nderi apo dekorim të shtetasve, Autoriteti ka kryer brenda afateve të kërkuara nga institucionet, procedurat për vlerësim të cilësive etike morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar apo zgjedhur në/nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kryeministria, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Ministria e Drejtësisë për Dhomën Kombëtare të Noterisë, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, MEPJ për titullarët e përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, Universiteti i Sporteve Tiranë dhe kërkesat për verifikimin e kandidatëve nga Departamenti i Administratës Publike, ISKK-ja apo institucioneve të tjera të paraqitura (Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare).

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2024, vetëm 26% e bashkive kanë vlerësuar zbatimin korrekt të ligjit nga ana e Autoritetit dhe kanë paraqitur kërkesë për të bashkëpunuar, me Autoritetin për kryerjen e

procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për tituj nderi apo emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh, ndërkohë që rreth 25% e tyre ka vijuar të japë tituj nderi apo të vendosin emërtimin e rrugëve, shesheve, hapësirave publike dhe monumenteve historike, kulturore, lapidarëve, me data, emra dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist, *pa zhvilluar procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës të shtetasve të propozuar.*

Afati kohor për trajtimin e kërkesave: afati kohor i përcaktuar në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit” për trajtimin e kërkesave, është 30 ditë. Në pjesën më të madhe të praktikave verifikuese, ky afat kohor është respektuar, përveç rasteve komplekse, si p.sh. rasti i një shtetasi i cili rezultoi në dokumente, në cilësinë e ndihmësgjyqtarit/gjyqtarit anëtar të Gjykatës Ushtarake dhe në cilësinë e hetuesit, në 266 dosje në ngarkim të 395 shtetasve të dënuar rast kur u shqyrtuan 10.870 faqe arkivore, si edhe dy raste për të cilat nevojitej që të analizohej përveç materialit arkivor, edhe kuadri ligjor i kohës për mbylljen e praktikave.


VI.4 MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT DHE RIKUPERIMIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË DIKTATURËS

Në zbatim të planit vjetor të punës të hartuar duke patur parasysh objektivat e vendosura në Planin Strategjik dhe atij të Veprimit të Autoritetit për vitet 2023-2028, aktivitetet dhe projektet kyçe të realizuara në drejtim të qartësimit të fatit të të zhdukurve dhe promovimit të drejtësisë tranzitore, mund të përmbledhen si në vijim:

VI.4.1 Administrimi i kërkesave nga familjarë, të afërm të personave të zhdukur apo palë të interesuara.

Statistika përmbledhëse

Viti	Nr. i kërkesave Total	Nr. i aplikantëve femra	Nr i aplikantëve meshkuj
2024	59	20	39
2023	59	9	50
2022	96	15	81
Total	214	44	170



VI.4.2 Identifikimi i vendvarrimeve

DMNPIRPZH-ja ka monitoruar vendvarrimet e identifikuara dhe të dyshuara të personave të zhdukur që mos të tjetërsohen si territore, e mos të ndërhyhet në to për asnjë lloj arsyeje. Po ashtu janë vendosur tabelat në 6 vendvarrime në Shpal, në fshat Shpal pranë varrezave-Orosh, në Selenicë, në Shkodër, në Grekan Njësia Sulç, në Kërbicë në Gramsh.

Janë për t'u vendosur tabela në 5 (pesë) vendvarrimet e tjera: Malësi e Madhe, Shelegur, Himarë, Kaçinar dhe Spaç.

Gjithashtu, për të gjitha kërkesat nga të afërm të personave të zhdukur, janë kryer disa kërkime si në Drejtorinë e Arkivit në Autoritet, në Ministrinë e Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe është bërë në kohë studimi i përgjigjeve dhe regjistrimi i tyre në një bazë të dhënash që përditësohet.

Hetimet administrative

Janë marrë 3 vendime lidhur me fillimin e procesit të verifikimit administrativ, si më poshtë:

1. Vendimi **nr. 385, datë 04.07.2024**, “Për miratimin e fillimit të procedurës së verifikimit të thelluar administrativ me qëllim identifikimin dhe rikuperimin të eshtrave të personave të ekzekutuar si pjesëtar të “grupit sabotator në Naftë dhe Ekonomi”.
2. Vendimi **nr. 617, datë 24/10/2024**, “Për fillimin e procedurave të verifikimit administrativ me qëllim identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur: Rait Alikaj”.
3. Vendimi **nr. 620, datë 01/11/2024**, “Për fillimin i procedurave të verifikimit administrativ me qëllim identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur: Dane Llalla, Zyhdi Çitaku, Hasan Hamza, Fiqiri Marika dhe Cene Cani”.

Realizimi i intervistave/dëshmime për personat e zhdukur

Gjatë vitit 2024 janë realizuar 5 dëshmi/intervista me familjarë dhe të afërm të personave të zhdukur. Këto intervista janë realizuar në ambientet e AIDSSH-së dhe 1 në Zagorë. Prej vitit 2022 janë realizuar gjithsej 12 dëshmi nga familjarët e të zhdukurve dhe ky numër përkon me numrin e intervistave/dëshmime të marra prej vitit 2017.

vi .4.3 Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe realizimi i draft-VKM-së në zbatim të ligjit nr. 45/2015

Drejtoria ka intensifikuar bashkëpunimin ndërinstytucional me Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit, ICMP-në, Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe pushtetin lokal.

Është lidhur marrëveshja me ICMP-në për fillimin e kërkimeve me metoda joinvazive në Shkodër, Mirditë dhe Himarë, proces ky që do të kryhet në vijimësi.

Një hap i rëndësishëm që është hedhur, është edhe përfshirja e pushtetit lokal përmes komunikimit institucional në njohjen e rezultateve të verifikimeve administrative lidhur me gjetjen e vendvarrimeve të dyshuara dhe kujdesin për vendvarrimet e identifikuara.

vi.4.4 Tregues të tjerë të punës

- Rritje e bashkëpunimit me institucionet vendase dhe ndërkombëtare për përshpejtimin e procesit të gjetjes së eshtrave.
- Rritje e ndërgjegjësimit publik për të denoncuar raste të personave të zhdukur dhe për të ndihmuar në procesin e dokumentimit.
- Përgatitje dhe përcjellje për miratim e projektvendimit “Për përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur ose ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991, si dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara të personave të zhdukur në këtë periudhë”.
- Pjesëmarrje në nisma të rëndësishme të promovimit të transparencës dhe drejtësisë tranzicionale, në dokumentimin e krimeve të komunizmit, përfshirë mbështetjen e procesit të identifikimit dhe rigjetjes së mbetjeve të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.
- Janë hartuar 2 (dy) projekt-ide lidhur me krijimin e dy memorialëve, një në *Tiranë* dhe një në *Rehovë*, në nderim të të varurëve dhe të të zhdukurve nga diktatura, si në burgje, kampe, hetuesi apo edhe në kufi. Sa i përket memorialit në Rehovë është krijuar skicë-ideja për memorialin me titull “Shtegu i Lirisë”, faza e dytë e ecurisë të të cilit u prezantua në aktivitetin e organizuar në Autoritet në datë 8 Maj 2024, “*Ekspozitë e dokumenteve arkivore*”.
- Janë diskutuar idetë dhe projektet e para për ngritjen e një memoriali të përgjithshëm në Tiranë, i cili do të shprehë në mënyrë të plotë pasojën e ardhur nga brutaliteti i diktaturës, të tregojë dinjitetin e mohuar të viktimave, dhimbjen dhe respektin shoqëror për to.

VI.5 MBËSHTETJA SHKENCORE DHE EDUKIMI QYTETAR



vi.5.1 Mbështetja shkencore për qëllime studimore e mediatike

Përgjatë vitit 2024 në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar, Autoriteti ka realizuar si më poshtë:

- 115 kërkesa studimore/mediatike të trajtuara në 33 mbledhje të Autoritetit, me 96 vendime për 130 678 faqe (11 186 prej të cilave anonimizuar). (pInformacion me te detajuar gjeni ne tabelën dhe grafikun meposhte)
- Hulumtuar 542 persona dhe 18 ngjarje, me 49 konsultime në sallë dhe 31 procesverbale dorëzimi.
- Organizuar 7 sesione “Arkiv i hapur” me 150 pjesëmarrës, duke mundësuar konsultime direkte me dosje.

Të dhëna mbi kërkesat e ardhura, të mbyllura, dosjet e shërbyera per vitin 2023-2024 si dhe struktura e kërkesave të ardhura mediatike dhe studimore per vitin 2024 jepen në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm.

	Kërkesa te ardhura	Kërkesa të mbyllura	Dosje të shërbyera
2023	112	83	923
2024	115	96	936



vi.5.2 Edukim qytetar dhe projekte

Gjatë vitit 2024, Autoriteti i Dosjeve ka vijuar me zbatimin e nismave kyçe duke u fokusuar në edukimin qytetar dhe kërkimin shkencor mbi të shkuarën komuniste. Aktivitetet e ndërmarra synojnë të ndërgjegjësojnë shoqërinë mbi pasojat e diktaturës dhe të ofrojnë qasje të hapur në dokumentet historike, duke kontribuar në ndërtimin e një kulture të kujtesës.

Gjatë vitit 2024 e në vijim fokusi është vendosur tek nismat kryesore, si:

(i) **Platforma:** “Mësojmë nga e Kaluara”;

- Klubi i Librit & Turi i leximit;
- Arkivi i hapur;

- (ii) **Simpoziume:** a) Simpozium mbi heronjtë e shkencës gjeologjike, b) “Kufijtë e Diktaturës 1944-1991”
- (iii) **Ekspozita;**
- (iv) **Dëshmitë e gjalla,** të cilat pasqyrojnë angazhimin e Autoritetit për të nxitur kërkimin shkencor dhe edukimin qytetar mbi të shkuarën komuniste;
- (v) **Aktivitete;**
- (vi) **Website;**
- (vii) **Botime.**

(i) Platforma “Mësojmë nga e Kaluara”

Platforma “Mësojmë nga e Kaluara – Burime Arsimore të Hapura 1944-1991” është një nismë e AIDSSH-së, e nisur në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (marrëveshja e 18.03.2021) dhe Këshillin e Europës, për të integruar historinë e diktaturës në kurrikulat shkollore dhe për të edukuar brezat e rinj. Qëllimi është të krijojë një platformë digjitale me dokumente, foto, filmime dhe botime që ndihmojnë në kuptimin e periudhës 1944 -1991.

Platforma synon të bëhet një mjet kryesor për edukimin qytetar duke ndihmuar të rinjtë të reflektojnë mbi pasojat e totalitarizmit dhe të ndërtojnë një vetëdije demokratike. Deri në konceptimin dhe zhvillimin e platformës, Autoriteti organizon aktivitete onsite, të cilat në të ardhmen do të shërbejnë si produkte të platformës.

- Klubi i Librit & Turi i leximit

U zhvilluan 6 Klube Libri “Mësojmë nga e kaluara”: 2 në Tiranë, Korçë, Lezhë, Kavajë dhe Durrës, me 346 pjesëmarrës (mësues, pedagogë, studentë, ish-të përndjekur politikë, familjarë të tyre, studiues etj.) gjithsej, duke përdorur letërsi memuaristike për të diskutuar mbi të shkuarën. Klubet ndihmuan në hapjen e dosjeve të figurave, si Drita Çomo e Liri Belishova, duke kombinuar letërsinë me dëshmi arkivore.

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës është organizuar një tur leximi: 5 takime leximi dhe informimi në qytetet: Kavajë, Tiranë dhe Durrës - me fokus Spaçin dhe botimet e AIDSSH-së, me 164 nxënës dhe mësues të arsimit parauniversitar. Turi vijon edhe gjatë vitit 2025 me 11 takime me shkolla nga Shkodra, Elbasani, Pogradeci, Përrenjasi, Bulqiza, Durrësi, Vlora dhe Tirana.

U prodhuan 18 video të publikuara në YouTube për të zgjeruar audiencën.

Organizimi i tyre ofron një qasje artistike dhe edukative për të kuptuar diktaturën duke nxitur reflektim kritik të të rinjtë dhe mësuesit.

- Arkiva e hapur

Janë zhvilluar 7 vizita në AIDSSH dhe arkivin e AIDSSH, me pjesëmarrjen e 160 vizitorëve.

(ii) Simpoziumet

- **Simpozium mbi heronjtë e shkencës gjeologjike,** viktima të regjimit (u çel fondi arkivor i degës së Sigurimit) Gjatë këtij simpoziumi u paraqiten 9 punime dhe morën pjesë 36 persona, ndër të cilët ishin studiues, inxhinierë, pedagogë dhe familjarë.
- **Kufijtë e Diktaturës 1944-1991”** në kuadër të 30 Gushtit, Ditës Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur, më 28 gusht u zhvillua në Pogradec simpoziumi “Kufijtë e Diktaturës 1944-1991” dhe u realizua një ekspozitë e dokumenteve arkivore dhe dëshmi të protagonistëve dhe familjarë që

kanë vuajtur pasojat me humbje të të afërmeve të tyre. Në këtë simpozium u prezantuan 16 punime & prezantime dhe morën pjesë rreth 80 persona.

(iii) Ekspozita

- Ekspozitë dokumentare dhe dëshmi të të prekurve e familjarëve: Arratisjet dhe vrasjet në kufirin juglindor.
- “Porto-Palermo tjetër - Nga kamp në përkujtim – Ekspozitë dhe aktivitet në përkujtim të këtij kampi në datën 23 gusht me rastin e Ditës Europiane të Kujtesës së Viktimave të Regjimeve Totalitare
- Ekspozita e portreteve dhe produkteve për Spaçin, të përgatitura nga AIDSSH.

(iv) Dëshmitë e gjalla

Dëshmitë e gjalla janë një shtyllë kryesore e edukimit qytetar, duke sjellë zërat e ish-të burgosurve dhe familjarëve të tyre.

- U mbledhën 25 dëshmi dhe u zbardhën 27 regjistrime audiovizuale nga ish-të burgosur dhe familjarë të të zhdukurve.
- U botua libri i mbështetur mbi dëshmitë e të mbijetuarve të dhe familjarëve të tyre i titulluar “50-vjet nga revolta e Spaçit” (vëllimi I)

(v) Aktivitete

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 30 aktivitete në ambientet e AIDSSH-së dhe jashtë saj.

(vi) Website

U lançua faqja www.spac.al me materiale për kampin-burg të Spaçit. Kjo faqe është në përditësim të vazhdueshëm. Deri në momentin e përpilimit të këtij raporti, faqja përmban: 7 rubrika, 27 nënrubrika, 12 dokumente nga AIDSSH, 7 dokumente nga Fondi 10, Ministria e Brendshme, 1 dokument nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë, 7 foto objektesh nga Muzeu Historik Kombëtar, 6 foto nga arkivat personale të ish- të dënuarve politikë në Spaç dhe familjarë të tyre, 14 foto të realizuara nga AIDSSH (foto galeri me rreth 85 foto nga aktivitetet AIDSSH), 1 dëshmi (video 1-minutëshe në youtube), 1 ekspozitë, 3 botime, 11 studime dhe artikuj/analiza.

(vii) Botime

- U përgatit dhe botua libri “Dielli lind në Spaç” dhe u punua për librin “Kufij të thyer” për nxënësit e Arsimit Parauniversitar të miratuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). “Kufij të thyer” do të printohet dhe vihet në dispozicion të publikut në vitin 2025.
- Janë përgatitur dhe publikuar buletinet dhe albumi i vitit 2024.

VI.6 SIGURIA DHE ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, Drejtoria përgjegjëse për Sigurinë dhe Teknologjinë e Informacionit ka realizuar një sërë aktiviteteve kyçe për garantimin e sigurisë institucionale dhe menaxhimin e informacionit të klasifikuar.

Po ashtu, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës digjitale, përfshirë menaxhimin e sistemit të arkivit digjital, implementimin e platformave e-Conference dhe e-Studim, si dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të institucionit. Në vijim, janë kryer trajnime dhe asistencë teknologjike për stafin, duke garantuar funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve elektronike.

Raporti pasqyron gjithashtu përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjen e parametrave të sigurisë, duke përfshirë bashkëpunimin me institucionet përkatëse dhe zbatimin e procedurave të akreditimit dhe certifikimit të sistemeve sensitive.

Në periudhën janar – dhjetor 2024, janë realizuar disa aktivitete kryesore si pjesë e detyrave funksionale, si: hapja dhe mbyllja e institucionit sipas protokolleve të sigurisë, kontrolli i pajisjeve të sigurisë, aplikimet për *certifikatat e sigurisë* për punonjësit dhe njohjen e stafit me instruktazhe sigurie. Gjithashtu, janë ndjekur procedurat për certifikimin dhe pajisjen e punonjësve të rinj me dokumente dhe karta aksesi, ndërsa janë mbajtur trajnime dhe brifime për informacionin e klasifikuar dhe debrifimi i punonjësve që kanë shkëputur marrëdhëniet me institucionin.

CSP	4 -MI	4- MII	4- M III	Viti 2024
Aplikime të reja për CSP	8	7	1	16
Aplikime për ri pajisje me CSP	3	Nuk ka	4	7

Numri i vizitorëve gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024, të cilët janë shoqëruar nga Sektori i Sigurisë Fizike dhe Digjitale, i kalon 1 216 (një mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) persona, nga të cilët 83 (tetëdhjetë e tre) janë vizitorë të huaj.

❖ Është monitoruar përgjatë gjithë vitit zbatimi i urdhrave të hartuar për vendosjen e parametrave të kërkuar të sigurisë për informacionin e klasifikuar. Është mbikëqyrur instalimi dhe konfigurimi i sistemit të shuajtjes së zjarrit si dhe është mbikëqyrur instalimi dhe konfigurimi i sistemit të alarmit.

❖ Gjatë vitit 2024, është asistuar stafi i Autoritetit në përballimin e problematikave të përditshme të përdoruesve të teknologjisë, duke garantuar funksionimin e kompjuterëve, printerëve, dhe pajisjeve të tjera. Janë kryer instalime të programeve të nevojshme për punën e secilit punonjës, ndërhyrje për probleme të printimeve, skanimeve dhe konvertimit të dokumenteve, si dhe përditësimi i fjalëkalimeve sipas kërkesave të rregullores. Po ashtu, është ofruar mbështetje për videoregjistrimet dhe menaxhimin e tyre.

Përveç kësaj, është vazhduar mirëmbajtja dhe përditësimi i faqes zyrtare të Autoritetit, duke shtuar materiale dhe informacione të nevojshme për transparencën dhe publikun. Me rritjen e dimensioneve të institucionit, është realizuar përmirësimi i strukturës dhe paraqitjes së faqes për të rritur qasjen e vizitorëve. Ndërkohë, është identifikuar nevoja për përmirësime të mëtejshme të faqes, për të cilën janë

marrë masa dhe është kërkuar buxheti për kontraktimin e një kompanie të specializuar që do të realizojë përmirësimet dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare për një periudhë dyvjeçare.

Të dhëna statistikore mbi numrin e publikimeve online

Publikime	Janar – dhjetor
Faqja zyrtare autoritetidosjeve.gov.al	32 deklasifikime sipas vendimeve përkatëse; 72 njoftime procedurash punësimi; 38 njoftime publike për aktivitete të ndryshme; 6 buletine për veprimtarinë e Autoritetit.
Klubi i Librit	4 publikime libra
ISSUU	5 publikime
Academia.edu	29 publikime/5 libra 24 buletine për veprimtarinë e Autoritetit

❖ Gjatë vitit 2024 është punuar intensivisht për vënien në funksion të sistemit të *arkivit digjital dhe menaxhimit të kërkesave*, duke bashkëpunuar me operatorin ekonomik të kontraktuar për implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Testimet e sistemit janë kryer periodikisht, me rritjen e ritmit të importimit të dokumenteve të skanuara. Janë importuar 605 GB dokumentacion arkivor për vitin 2023, përkatësisht 1 381 418 dokumente. Gjithashtu, është përgatitur draft-udhëzuesi dhe manuali teknik për përdorimin e sistemit, dhe janë hartuar rregullore dhe udhëzime për funksionimin e sistemit të arkivit digjital dhe sistemit të menaxhimit të kërkesave. Po ashtu, janë hedhur në sistem praktikat studimore dhe ORV (Dosje të Objekteve të Rëndësisë së Vecantë për vitin 2024.

Për sa i përket *sistemeve e-Conference dhe e-Studim*, është monitoruar zbatimi i kontratës për blerjen dhe instalimin e pajisjeve audiovizuale për vënien në funksion të Sistemit e-Conference në sallën e mbledhjeve të Autoritetit, duke përfshirë terminale *paperless* dhe pajisje mbështetëse. Po ashtu, është instaluar dhe konfiguruar sistemi *e-Studim* me kompjuterë të konfiguruar në një rrjet të mbyllur, që do të mundësojë aksesin e studiuesve në materialet e kërkuara. Të dyja sistemet janë funksionale dhe përdoren për qëllime të ndryshme brenda Autoritetit.

❖ Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe nënligjore në fushën e informacionit të klasifikuar dhe në zbatim të VKM-së nr. 542, datë 25.07.2019 dhe VKM-së nr. 312, datë 16.03.2011, informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” i cili shkëmbehet nëpërmjet rrjeteve informative, kryhet kur pajisjet janë të certifikuara përshtatshmërisht. Është hartuar dokumentacioni për procedurat e operimit të sigurt dhe koncepti i operimit të sistemit me qëllim iniciimin e procesit të akreditimit të sistemit, si dhe janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me AKSIK-në.

VI.7 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

AIDSSH-ja synon të forcojë ndërveprimin ndërkombëtar përmes shkëmbimit të përvojave, bashkëpunimit me institucione homologe dhe pjesëmarrjes aktive në platforma evropiane, me qëllim promovimin e transparencës arkivore dhe studimin e së kaluarës me qasje shkencore.

Në vitin 2024, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) mori pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare që trajtuan çështje kyçe mbi kujtesën historike, edukimin e historisë dhe transparencën e arkivave. Nga forumet akademike të simpoziumeve mbi përkujtimin dhe lirinë, si dhe konferencat mbi menaxhimin e arkivave të ish-policive sekrete, përfaqësuesit e AIDSSH-së prezantuan përvojën dhe angazhimin e institucionit për të siguruar aksesin në dokumentet historike dhe për të promovuar një qasje të hapur ndaj së kaluarës. Këto aktivitete theksuan rëndësinë e studimit shkencor të historisë, sfidat e ruajtjes së arkivave dhe rolin e teknologjisë në edukimin historik. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e pjesëmarrjes dhe kontributit të AIDSSH në këto evente:

1. Forumi i Këshillit të Evropës në Bolonjë, 15-16 Maj 2024, Bolonjë, Itali

Forum i Këshillit të Evropës i organizuar në Bolonjë në datat 15-16 maj 2024, trajtoi sfidat dhe kërcënimet në mësimdhënien e historisë, duke theksuar rrezikun e mohimit të fakteve historike dhe manipulimit politik. Kryetarja e AIDSSH-së, Dr. Gentiana Sula, prezantoi përvojën e institucionit në sigurimin e aksesit në dokumentet historike dhe ndikimin e tij në njohjen e së kaluarës. Diskutimet përfshinë sfidat e lirisë akademike, ndikimin e narrativave të ndryshme dhe nevojën për një histori gjithëpërfshirëse. Forumi synonte të promovonte dialogun dhe praktikën më të mira në edukimin historik në Evropë.

2. Simpoziumi i 12-të i Rrjetit Evropian të Kujtesës “Përkujtimi dhe rrëfimi i lirisë”, 21-24 Maj 2024, Varshavë, Poloni .

AIDSSH-ja mori pjesë në cilësinë e institucionit vëzhgues në Simpoziumin e 12-të Evropian të Kujtesës, që u mbajt më 21 – 24 maj 2024 në Muzeun e Historisë Polake në Varshavë. Simpoziumi shqyrtoi ndikimin e luftës për liri në kujtesën historike evropiane, veçanërisht në kontekstin e luftërave botërore, nazizmit, komunizmit dhe regjimeve autoritare të shekullit XX. Në Simpozium u diskutuan tema të tilla si: interpretimi i lirisë në narrativat muzeale dhe në kulturën e kujtesës; roli i muzeve historikë në ruajtjen e kujtesës dhe ndërveprimin me publikun dhe përdorimi i teknologjive të reja si AI, VR dhe media imersive në edukimin historik dhe sfidat që ato sjellin.

3. Konferenca “Perspektivë e përbashkët-veprime të sinergjizuara” e Rrjetit Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dosjet e ish –Policive Sekrete 03-05 Tetor 2024, Tiranë.

Në kuadër të presidencës së radhës nga ana e Shqipërisë, më datë 03-05 tetor 2024 u organizua nga AIDSSH-ja konferenca “Perspektivë e përbashkët-veprime të sinergjizuara” e Rrjetit Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dosjet e ish-Policive Sekrete. Rrjeti Evropian i Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dosjet e ish-Policive Sekrete u formua në Dhjetor të vitit 2008 si një platformë bashkëpunimi që lidh institucionet që administrojnë koleksionet arkivore të forcave të policive sekrete të shteteve ish-komuniste. Morën pjesë përfaqësues të anëtarëve të Rrjetit, përfaqësues të Trupit Diplomatik, përfaqësues të Kuvendit, punonjës të AIDSSH-së, përfaqësues të të përndjekurve politikë, përfaqësues të medias etj.

Në këtë simpozium u prezantuan sfidat dhe arritjet e institucioneve arkivore, përfshirë projektet për digitalizimin dhe krijimin e mediatekës. Diskutimet u fokusuan në qasjen ndaj arkivave, sfidat institucionale dhe nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar në trajtimin e së kaluarës.

Në kuadër të angazhimeve të marra në këtë konferencë, u zhvillua në dhjetor 2025 një takim *online* mes anëtarëve të rrjetit me temë inteligjencën artificiale dhe arkivat digjitale, aktivitet i cili do të pasohet nga një takim me prezencë fizike në Poloni, gjatë vitit 2025.

4. Konferenca e IV-t Vjetore e Observatorit për Mësimdhënien e Historisë në Evropë, 4-6 Dhjetor 2024, Strasburg, Francë.

Konferenca e IV-t Vjetore e Observatorit për Mësimdhënien e Historisë në Evropë (OHE), me temë “Historia në Krizë”, u zhvillua më 4-6 dhjetor 2024 në Këshillin e Evropës, Strasburg. Ngjarja u fokusua në sfidat e mësimdhënies së historisë në kontekstin e krizave globale dhe instrumentalizimit politik të së kaluarës. Diskutimet kryesore trajtuan: rëndësinë e një qasjeje të pavarur dhe multidimensionale në edukimin e historisë për të promovuar vlerat demokratike; luftën kundër keqpërdorimit politik të historisë dhe rëndësinë e mendimit kritik tek studentët; bashkëpunimin ndërdisiplinor mes politikëbërësve, edukatorëve dhe institucioneve kulturore; rolin e teknologjisë (AI, VR, mjete dixhitale) për ta bërë historinë më tërheqëse dhe të aksesueshme. Konferenca mbledhi mbi 150 pjesëmarrës, përfshirë ministra dhe zëvendësministra të arsimit nga vende të ndryshme, si dhe drejtues të strukturave të Këshillit të Evropës. Kryetarja e AIDSSH, Znj. Gentiana Sula, dhe delegacioni i Autoritetit zhvilluan takime për mundësi bashkëpunimi mbi platformën e edukimit dhe strategjinë e komunikimit të AIDSSH.

VII. OBJEKTIVAT E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2024

1. Intensifikim i bashkëpunimit me institucionet publike për marrjen e materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe dokumenteve arkivore, me synim pasurimin e arkivit, dhe për të garantuar një kërkim sa më shterues në funksion të kërkesave të qytetarëve/subjekteve;
2. Rritje e efikasitetit të kërimit në arkiv nëpërmjet Projektit të Kartotekës, i cili mundëson aplikimin e mjeteve të reja të kërimit në procesin e trajtimit të kërkesave;
3. Deklasifikim dhe skanim masiv i dokumenteve arkivorë në kuadër të objektivit për një hapje totale të arkivit të ish-sigurimit dhe vënie në efikasitet të plotë të arkivës digjitale;
4. Informacion për të gjithë, në kuadër të informimit apo të studimit, nëpërmjet krijimit të lehtësirave procedurale, digjitalizimit dhe zgjerimit të spektrit në informacionin e aksesueshëm;
5. Angazhim në përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, por edhe të Kodit Zgjedhor apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare;
6. Përmirësimi i procedurave të ndjekura për verifikimin e subjekteve, për t'a bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për institucionin;
7. Krijimi i bazës së të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit;
8. Edukim dhe ndërgjegjësim shoqëror nëpërmjet një platforme komunikimi në spektër 360 gradë përfshirë komunikimin virtual dhe platformat digjitale;
9. Kryerja e veprimtarive informuese nga Autoriteti në bashkëpunim me partnerë lokalë kombëtarë e ndërkombëtarë në terren për t'a prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri;

10. Bashkëpunim me ICMP-në (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) në kuadër të kërkimit dhe qartësimit të fatit të personave të zhdukur;
11. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet plotësimit të pozicioneve të lira si dhe trajnimeve brenda dhe jashtë vendit në institucione homologe;
12. Menaxhim më efektiv i prokurimeve të fondeve buxhetore, nëpërmjet një planifikimi sa më realist të nevojave të institucionit në përputhje me ligjin ‘Për prokurimin publik’, të ndryshuar dhe legjislacionin në fuqi.

VIII. OBJEKTIVA DHE INDIKATORË TË SYNUAR PËR 2025

1. Thellim i bashkëpunimit ndërkombëtar për financimin dhe asistencën teknike të vijueshme në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të personave të zhdukur;
2. Zgjerimi i hetimeve administrative dhe aplikimi i mjeteve/logjistikës bashkëkohore për detektimin e eshtrave në 2 vendvarrime të dyshuara nëpërmjet bashkëpunimit me ICMP;
3. Ngritje e kapaciteteve: në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) nëpërmjet trajnimit të stafit të Drejtorisë përgjegjëse, për përdorimin e platformës ndërkombëtare “Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Integruara” (iDMS), i cili përdoret sot nga shumica e shteteve që kanë problematika lidhur me personat e zhdukur.

Synohet që në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 të jetë përmbushur detyra e caktuar nga rezoluta e Kuvendit, duke përdorur tre modulet e para të iDMS, përmes kalimit në to të informacionit që ka mbledhur Autoriteti në databazën e të dhënave:

- ❖ Moduli i parë ka të bëjë me të dhëna mbi personat e zhdukur;
 - ❖ Moduli i dytë ka të bëjë me të dhëna rreth familjarëve e trashëgimtarëve të personave të zhdukur;
 - ❖ Moduli i tretë ka të bëjë me informacionin rreth vendvarrimeve të identifikuara e të dyshuara të personave të zhdukur.
4. Startim i implementimit të dy projekteve për ngritjen e memorialeve të kujtesës në bashkëpunim me pushtetin vendor në Shkodër dhe Ersekë;
 5. Rritje e efikasitetit të veprimtarisë së Autoritetit nëpërmjet Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Pushtetin Vendor për çështje që lidhen me të zhdukurit, kujtesën, aktivitetet me karakter edukues dhe ndërgjegjësues;
 6. Rritja e aksesit virtual të publikut përmes kontraktimit, bërjes funksionale të platformës online (Mediateka);
 7. Intensifikim i punës ndërgjegjësuere me pushtetin vendor me qëllim përfshirja e të 61 bashkive në fund të vitit 2028 në proceset e verifikimit të figurave, nga 26 të përfshira aktualisht përmes fushatave të dialogut dhe bashkëpunimit;
 8. Digjitalizimi i 75-80 % të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit deri në vitin 2028. Aktualisht është digjitalizuar rreth 33 %;
 9. Deklasifikimi i 80 % dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit deri në fund të 2028;
 10. Rritja e efikasitetit të trajtimit të kërkesave të ardhura nga individë, qytetarë, institucione studiu etj.

IX. DETYRIMET LIGJORE NGA AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSITË NË RASTET KUR LIGJI ËSHTË SHKELUR APO NUK ËSHTË KONSIDERUAR

Në komunikim aktiv me publikun dhe të interesuarit për realizimin e detyrave funksionale, Autoriteti është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, nuk ka pasur raste të tejkalimit apo keqpërdorimit të kompetencave në ushtrimin e funksioneve për të cilat ligji nr. 45/2015, i ndryshuar dhe Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit e ngarkojnë.

Autoriteti në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit ka azhurnuar programin e transparencës së Autoritetit duke bërë publike të gjitha dokumentet e parashikuar në ligjin nr. 119/2014, i ndryshuar.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit ka dhënë brenda afatit kohor ligjor përgjigje për 14 kërkesa të paraqitura pranë Autoritetit për informacion në bazë të ligjit nr. 119/2014. Vetëm për një kërkesë ka patur ankim pranë Komisionerit. Procedura nuk ka vijuar më tej me shqyrtimin e ankimit nga ana e Komisionerit për shkak të përcjelljes së informacionit kërkuar menjëherë pas deklasifikimit.

Niveli i zbatimit të Kodit të Sjelljes së Mirë Administrative dhe Kodit të Etikës nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi

Kodi i miratuar për të promovuar si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit një kulturë administrative, të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, si dhe ofron udhëzime në lidhje me hapat praktikë që duhen ndjekur për të siguruar më shumë efektshmëri, transparencë dhe përgjegjësi. Në këtë kuadër, theksojmë se, në veprimtarinë e përditshme të punës në komunikimet me titullarin, anëtarët e Autoritetit, me kolegët si dhe me subjektet e interesuar që i drejtohen Autoritetit dhe që paraqesin kërkesa për informim, punonjësit e institucioneve të tjera të administratës publike/ personave të tretë të lidhur me ta, udhëhiqet në çdo rast nga respektimi i parimeve bazë të ligjit nr.45/2015 i ndryshuar, të zbatimit të rregullores “*Për organizimin dhe funksionimin e AIDSSH-së*”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, ndryshuar me vendimin nr. 234, datë 24.04.2019 të Autoritetit, të “*Kodit të Sjelljes së Mirë Administrative dhe Kodit të Etikës nga sekretariati teknik dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi*”, si dhe të zbatimit të çdo akti tjetër ligjor apo nënligjor që na ngarkon për zbatim.

Veprimtaria në kuadër të ndjekjes dhe zbatimit të ligjit për kontrollin e interesit, pjesë e Autoritetit

1. Hartimi i raportit vjetor të vitit 2024 dhe dërgimi brenda afateve ligjore të Raportit në ILDKPKI-së.
2. Njoftimi dhe ndjekja e afateve ligjore për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratave të interesave private periodike vjetore, para fillimit në detyrë dhe pas largimit nga funksioni të subjekteve deklaruese të Institucionit.
3. Rakordimi i listës së subjekteve midis institucionit të Autoritetit dhe ILDKPKI-së.
4. Përgatitja dhe administrimi i gjithë dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të udhëzimit për Autoritetin Përgjegjës, me qëllim vënien në dispozicion të Institucionit kontrollues dhe monitorues të ILDKPKI-së.
5. Ndjekja e dorëzimit elektronikisht dhe zyrtarisht brenda afateve ligjore të deklaratave të interesave private periodike vjetore, të gjithë subjekteve deklaruese të Autoritetit.

6. Asistencë për secilin nga subjektet deklaruuese të Autoritetit, të cilët kanë ndjerë nevojën për ndihmë. Komunikim i vazhdueshëm me nëpunëset e ILDKPI-së.

Në vitin 2024 është rekrutuar personel, subjekt deklarimi, njoftuar për plotësimin e deklaratave të tyre “Para fillimit të detyrës” dhe “Pas largimit nga funksioni”, për të cilët është bërë dhe njoftimi i institucionit të ILDKPI-së për ndryshimet në regjistrë.

X. NDRYSHIMET NË KUADRIN RREGULLATOR PËR VITIN 2024 DHE EFEKTET E TYRE

Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, është ndryshuar në vitin 2022. Gjatë vitit 2024 ky ligj nuk ka pësuar ndryshime.

Gjatë vitit 2024, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka punuar për përmirësimin e akteve nënligjore dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional. Më konkretisht:

- Është miratuar me vendimin nr. 177, datë 04.04.2024 “Udhëzuesi mbi rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person”.
- Është miratuar me vendimin nr. 743, datë 19.12.2024 “Udhëzuesi për aksesin dhe përdorimin e arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”.
- Me qëllim rritjen e aksesit dhe transparencës mbi dokumentacionin e ish Sigurimit të Shtetit, janë lidhur 5 (pesë) Marrëveshje të cilat mundësojnë **shkëmbimin e informacionit, digjitalizimin e të dhënave dhe organizimin e aktiviteteve në funksion të ruajtjes së kujtesës kolektive:**

1. **Me kolegjin Universitar “Bedër”** – në fokus: Bashkëpunim për sigurimin e dosjeve digjitale mbi personalitetet dhe klerin mysliman, organizimin e aktiviteteve akademike dhe trajnimeve.
2. **Me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit** – në fokus: Projekte për promovimin e studimeve historike, nxitjen e leximit dhe ndërgjegjësimin për përndjekjen gjatë regjimit komunist përmes materialeve digjitale dhe dëshmime gojore.
3. **Me Radio Televizionin Shqiptar (RTSH)** – në fokus: Shkëmbimi dhe studimi i materialeve arkivore dhe filmike mbi periudhën komuniste, për të pasuruar kujtesën kolektive dhe transparencën historike.
4. **Me Shoqatën Patriotike “Çamëria”** – në fokus: Hulumtime mbi persekutimin e komunitetit çam gjatë regjimit komunist, përmes dokumenteve arkivore dhe studimeve historike.
5. **Me Shoqatën Kombëtare Antikomuniste e Ish-të Përndjekurve Politikë** – në fokus: Identifikimi dhe dokumentimi i përndjekjes politike në Shqipëri përmes arkivave të ish-Sigurimit të Shtetit.

XI. MBI PROBLEMATIKAT E NDESHURA NË VEPRIMTARINË E AUTORITETIT ME QËLLIM GJETJEN E RRUGËVE MË EFIKASE PËR ZGJIDHJEN E TYRE NGA KUVENDI DHE KËSHILLI I MINISTRAVE

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka paraqitur disa problematika që i ka hasur në punën e tij të cilat përkthehen në propozime të mundshme për të bërë disa ndryshime apo shtesa në ligjin funksional nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të

Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, apo të ndonjë ligji tjetër, të cilët do të ndikonin në cilësinë e punës së Autoritetit.

xi.1 Në lidhje me menaxhimin e fondit arkivor

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për arkivat”, nga data 1 Janar 2025, arkivi i sistemit të Ministrisë së Brendshme dhe të Forcave të Armatosura ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Aktualisht, Autoriteti ndodhet në kushtet ku Ministria e Brendshme nuk i administron më fondet e listuara në urdhrin nr.103, datë 14.06.2022. Kjo e provuar edhe nëpërmjet shkresës nr. 136, datë 24.01.2025 (protokolluar në AIDSSH) ardhur nga Ministria e Brendshme, ku informohemi se pas këtyre ndryshimeve aktet e përbashkëta të nënshkruara nuk do të jenë më në fuqi.

Autoriteti duhet të diskutojë rrethana të reja të shfrytëzimit arkivor me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, pasi Ministria e Brendshme nuk ka asnjë tagër të trajtojë fondet arkivore të ish-Drejtorisë së Arkivit të Sistemit në raport me Autoritetin.

Këto rrethana pengojnë Autoritetin në ushtrimin e detyrave funksionale duke çuar në vendimmarrje jo të plota, joshteruese për mungesë të fondeve arkivore të kërkuara duke cenuar dhe besueshmërinë e publikut në punën e institucionit.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 13, pika 4 të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH-së, i ndryshuar, i cili citon se: “Kur autoriteti publik ose arkivi merr një kërkesë, sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij neni, i përgjigjet Autoritetit, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, duke i vënë në dispozicion, sipas rastit, dokumentet ose kopje apo dublikata të tyre”. Pas zbatimit të procedurave ligjore të parashikuara në nenin 13 të ligjit 45/2015, i ndryshuar, nga ana e Autoritetit do të vijohet me kërkesën për procedurën e kalimit të këtyre fondeve në administrimin e Autoritetit.

Vazhdon të mbetet problem fakti që një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit të ish-Sigurimit të Shtetit ndodhet nëpër arkivat e institucioneve si trashëgimi institucionale, e papërdorshme dhe ndoshta jo e njohur mirë nga administratorët e tij. Ky dokumentacion tashmë nuk mund të trajtohet e mbetet vetëm shqetësim dhe paqartësi, mbi detyrimin e autoriteteve të tjera shtetërore të dorëzojnë dokumente që mund të mos (konsiderohen) të kenë lidhje me atë nocion të paqartë të ish-Sigurimit të Shtetit. Siç e kemi trajtuar edhe më herët, Autoriteti është institucioni i krijuar me ligj dhe i specializuar për realizimin dhe kryerjen e një procesi të tillë dhe mbetet i hapur dhe i gatshëm që të marrë përgjegjësi e japë ndihmesë. Po kështu jemi të vetëdijshëm se lidhja e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit me veprat penale politike ka vështirësi, për vetë faktin se një pjesë e madhe e dokumenteve janë të asgjësuara, gjë që sjell vështirësi teknike për stafet e institucioneve dorëzuese dhe institucioneve marrëse. Në këto kushte, kërkohet impenjim dhe bashkëveprim ndërinstitutional në mënyrë që të lehtësohet procesi i identifikimit dhe dorëzimit të dokumenteve të ish- Sigurimit të Shtetit, pranë Autoritetit.

Zbatimi i VKM-së nr. 98/2017, me objekt realizimin e procesit të kalimit nën administrim dhe të marrjes në dorëzim të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, vijon të ketë/sjell vështirësi me procesin e dorëzimit të fondeve arkivore. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nuk është dorëzuar asnjë fond apo dokument arkivor pranë Autoritetit. Gjatë komunikimeve zyrtare pretendohet se fondet janë të papërpunuara dhe ka vështirësi në identifikimin e dokumenteve të ish Sigurimit, proces ky që kërkon

shumë burime njerëzore dhe kohë. Ligji nr. 45/2015, i ndryshuar, parashikon ndër dokumentet e ish-Sigurimit në nenin 3 pika 5 germa c) “dokumentet e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe organizatave politiko-shoqërore që kanë lidhje me veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit, vetëm në masën dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, të këtij ligji”. Kalimi në administrim i këtyre dokumenteve arkivore nga DPA është i domosdoshëm që Autoriteti të ushtrojë plotësisht detyrën e tij ligjore lidhur me verifikimin në këto fonde kur kërkohet për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, propozimet për dekorim dhënie titujsh nderi dhe emërtime hapësirash publike.

xi.2. Në lidhje me çështjen e personave të zhdukur

xi.2.1. Vonesa në miratimin e VKM-së për personat e zhdukur ka penguar gërmimet.

Në nenin 22/1, pika 1.1 të ligjit 45/2015, i ndryshuar, parashikohet se në kuadër të Marrëveshjes së Këshillit të Ministrave me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 83/2018, Autoriteti ndërvepron me Ministrinë e Brendshme për sa u takon instrumenteve ligjore dhe institucioneve në varësi të saj. Ministria e Brendshme, e cila duhet të luante një rol kyç në këtë proces, nuk e ka konsideruar si pjesë të detyrave të saj nismën për zgjidhjen e kësaj çështjeje edhe pse ligji nr. 45/2015 e përcakton qartë rolin e saj, duke krijuar kështu një ngërç institucional në procesin e miratimit të tij.

xi.2.2. Mungesa e burimeve financiare dhe stafit të specializuar për hetime më të thelluara.

xi.3. Në lidhje me kërkesat e ardhura në Autoritet nga qytetarët për qëllime rehabilitimi/dëmshpërblimi:

Një numër i madh kërkesash janë paraqitur nga persona që dikur kanë qenë burgosur/dëbuar/internuar, për qëllime rehabilitimi/dëmshpërblimi. Shumë prej tyre kanë lindur në internim ose kanë qenë minorenë gjatë internimit të familjarëve të tyre. Problemi kryesor në këtë fushë ka qenë se Komisioni i Internim-Dëbimeve nuk ka marrë vendime specifike për këtë kategori personash, ndaj nuk ekziston dokumentacion arkivor për ta. Si rezultat, këta individë nuk mund të përfitojnë shtesën e pensionit për periudhën e internimit, duke shkaktuar pakënaqësi dhe mungesë mundësish për një zgjidhje të favorshme.

Janë paraqitur zyrtarisht nga Autoriteti disa sugjerime për ndryshime ligjore mbi parashikime të posaçme mbi mekanizimin e vërtetimit të qenies së personit të lindur apo të mitur në internim përmes verifikimit administrativ të dokumentacionit.

xi.4. Në lidhje me verifikimin e figurave

Vijon të mbetet problematike mungesa e bashkëpunimit nga ana e shumë prej organeve të pushtetit vendor për zbatimin korrekt të ligjit nga ana e Autoritetit për kryerjen e procesit të verifikimit të figurës së personave që propozohen për dekorim, tituj nderi apo propozimeve për emërtimin e hapësirave publike me emra personalitetesh.

Vijon të mbetet problematikë mosmarrja në konsideratë dhe mungesa e bashkëpunimit nga ana e partive politike apo koalicioneve të regjistruara në zgjedhjet parlamentare dhe ato vendore në kuadër të vlerësimit të pastërtisë së figurës të kandidatëve për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkish dhe kryetarë këshilli qarku, në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në

dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet prej tyre për qëllime të transparencës së figurës, gjatë fushatave elektorale parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 45/2015.

xi.5 Në lidhje me kategorinë e pagave

Në vitin 2023, si pasojë e reformës në sistemin e pagave në shërbimin civil, ka lindur një diferencë midis pagave të sekretariatit teknik dhe pagave të anëtarëve të organeve kolegjiale. Kjo situatë ka shkaktuar dëmtimin e hierarkisë së pagave në institucionet kolegjiale. Në këtë kuadër, është e nevojshme të gjendet një mekanizëm që mundëson rregullimin e pagës për *anëtarët e organeve kolegjiale*. Referenca e pagës për anëtarët e Autoritetit në raport me pagën e Presidentit të Republikës, ka pësuar një ulje, duke kaluar nga 55% në 45%. Kjo nënkupton se referenca për pagën e anëtarëve të Autoritetit është ulur me 19%. Po ashtu, kjo diferencë bëhet më e dukshme kur bëhet krahasim me institucionet e tjera të krijuara me ligj, të cilat nuk kanë pësuar ulje në % e tyre në raport me pagën e Presidentit.

XII. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT OSE NË PËRGJITHËSI NË LIGJE, AKTE NËNLIGJORE APO DISPOZITA QË JANË DETYRUESE PËR INSTITUCIONIN

Nevojat për ndryshime ligjore gjatë punës së Autoritetit gjatë zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të realizimit të detyrave për vitin 2024 për zgjidhjen e të cilave kërkohen ndryshime ligjore në ligjin nr. 45/2015 i ndryshuar për çështjet si më poshtë:

- Njohja e dëmshtëpërblimit të drejtë të ish-të përndjekurve politikë dhe familjarëve të tyre;
- Qartësimi i fatit të personave të zhdukur gjatë komunizmit;
- Verifikimi i figurave;

Me qëllim harmonizimin e legjislacionit, konstatojmë nevojën edhe për disa ndryshime dhe shtesa përtej ligjit 45/2015:

- Ligj nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 93/2022 datë 08.02.2024, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligj nr. 138/2015 “Për garantimin e pastërtisë së figurës të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.

Për këtë qëllim po punohet për draftimin e propozimeve konkrete të cilat do t’i paraqiten Kuvendit sapa të jenë dakortësuar në organin kolegjial.

XIII. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONIT - STRUKTURA DHE ORGANIKA E AUTORITETIT


Struktura dhe organika e Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë, nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 26/2022, datë 17.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në

vendimin e Kuvendit nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””, ndryshuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr.19/2023, datë 16.3.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit””, u ndryshua struktura dhe organika e AIDSSH-së, si dhe u rrit numri total i punonjësve nga 65 në 73. Nga kjo strukturë konsiston që 5 prej tyre janë Anëtarët e Autoritetit, të zgjedhur dhe të emëruar nga Kuvendi me vendimet përkatëse; nr. 43, nr. 44, nr. 45, nr. 46, nr. 47, datë 09.06.2022

Për vitin 2024, numri i punonjësve efektivë në total është 70 ose 96 % e strukturës së miratuar, nga të cilët:

1. Anëtarë të Autoritetit 5 (pesë)
2. Nëpunës Civilë 59 (pesëdhjetë e nëntë)
3. Punonjës me “Kod Pune” pjesë e strukturës, 6 (gjashtë)
4. Vende vakante, nëpunës civilë 3 (tre)

Nisur nga fakti i shfuqizimit të VKM-së nr. 187, datë 8.3.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar, i cili u zëvendësua me VKM-në nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr.113/2023, datë 2.11.2023, “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” të ndryshuar”, reflektoi ndryshimet përkatëse të klasave dhe kategorive të nëpunësve civilë në strukturën dhe organikën e AIDSSH-së, si më poshtë:



xiii.1. Punësimi i punonjësve sipas organigramës

Siç është theksuar më sipër, në fund të vitit 2024 rezultojnë 3 vende vakante me fond page për rekrutim punonjës në nivelin ekzekutiv respektivisht në Drejtorinë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, Drejtorinë e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur dhe Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, Digjitalizimit dhe Sigurisë.

Gjatë vitit 2024, janë kryer në total 19 shpallje për procedura rekrutimi. Kanë shprehur interes në këto procedura 32 kandidatë, nga të cilët janë kualifikuar për të hyrë në testim 29 kandidatë. Pas kryerjes së procedurave të përzgjedhjes sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për rekrutimet, janë shpallur fitues 16 kandidatë.

xiii.2. Punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 1.2.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”, AIDSSH-së iu dha e drejta të punësonte 20 (njëzet) punonjës me kontratë të përkohshme përkatësisht në pozicionet:

- 4 (katër) punonjës me emërtim “Operatorë”;
- 4 (katër) punonjës me emërtimin “Arkivist”;
- 4 (tetë) punonjës me emërtimin “Nëpunës informacioni”;
- 1 (një) punonjës me emërtimin “Bibliotekar”;
- 1 (një) punonjës me emërtim “Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme”

xiii.3. Puna vullnetare pranë Autoritetit

Gjatë vitit 2024, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet AIDSSH-së dhe Universitetit të Tiranës, 6 (gjashtë) studentë kryen praktikën mësimore prej 21 ditësh pranë AIDSSH-së dhe 2 (dy) të tjerë janë duke e zhvilluar atë edhe gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2024, në kuadër të thirrjes së IX-të, të “Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, të inicuar, drejtuar dhe udhëhequr nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, edhe pse u realizuan të gjithë procedurat përkatëse, nuk pati asnjë praktikant të identifikuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për kryerjen e praktikës të punës pranë AIDSSH-së.

xiii.4. Trajnimet e punonjësve

Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me ASPA dhe institucione të tjera, janë kryer on-line një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve, ku përfshihen dhe trajnimet e 13 punonjësve në kuadër të pranimit në shërbimin civil me temë *"Prezantimi me administratën publike"*.

Temat në këto trajnime janë përzgjedhur nga punonjësit për përmirësimin e aftësive menaxheriale dhe ngritjes profesionale, në funksion të realizimit të detyrave sipas pozicioneve të punës apo dhe të detyrave të reja të ngarkuara. Gjithsej 79 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuar nga ASPA për vitin 2023.

xiii.5. Kontrollat nga institucionet kompetente gjatë vitit 2024

- ***Kontrolli nga KMSHC mbi mbikëqyrjen e përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në AIDSSH***

Në periudhën 5 shkurt-29 mars 2024, një grup punonjësish të KMSHC-së kryen procesin e kontrollit dhe mbikëqyrjes pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv-Protokollit në lidhje me zbatimin konkret të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në AIDSSH.

Në përfundim të procesit të kontrollit dhe mbikëqyrjes, gjetjet përkatëse dhe konkluzionet në raportin përfundimtar të KMSHC konsistojnë: Komiteti i Përhershëm i Pranimit duhet të funksionojë si një i vetëm, për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit; - mungesa e komenteve në shumicën e rasteve në rubrikat e vlerësimit të performancës; - Në procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, miratimi nga titullari i institucionit është bërë vetëm në rrugë elektronike (email) dhe jo me vendim ashtu si e kërkon ligji. Njësia përgjegjëse, për rregullimin e situatës në vijim, duhet të respektojë përcaktimet e nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, ku citohet se organi kompetent (në këtë rast titullari i institucionit) duhet të shprehet me vendim për pozicionin që do të plotësohet me këtë procedurë.

Sa më sipër, KMSHC-ja shprehet se rekomandimet e mësipërme paraqesin disa elementë parregullsie të konstatuara nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, **nuk cenojnë thelbin e proceseve të realizuara.**

- ***Kontrolli i Ministrisë së Financave në kuadër të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, MFK***

Në periudhën 28 tetor – 1 nëntor 2024, nga Ministria e Financave është kryer një kontroll lidhur me cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Në përfundim kontrolli ka konkluduar se Sistemi i Kontrollit të Brendshëm i Autoritetit vlerësohet efektiv, pra në nivelin më të lartë, ndërkohë **që** janë lënë disa rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me:

1. Vijimin me procesin e rishikimit të strategjisë së riskut;
2. Përgatitjen e manualit të proceseve të punës dhe gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës së Autoritetit;
3. Të ndiqet plani i veprimit për ngritjen e sistemit të MFK;
4. Të përdoret më shumë instrumenti i delegimit.

XIV. TË DHËNA PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E AUTORITETIT

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2024 administroi dhe menaxhoi fonde nga disa burime financimi, si më poshtë:

1. Fondet nga Buxheti i Shtetit të miratuara me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” sipas planit fillestar të buxhetit në vlerën 132,651,000 lekë.
2. Financim
3. Të ardhurat dytësore, të cilat realizohen në zbatim të VKM nr. 93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”

XIV.1. FONDET BUXHETORE

Me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit iu miratua numri i përgjithshëm prej 73 punonjësish dhe mbështetur në vendimin e Kuvendit nr. 19/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 95/2016 për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, ka ndryshuar dhe struktura e Autoritetit.

Për vitin 2024, me ligjin e buxhetit fondet e akorduara për institucionin janë 165,9000,000 lekë. Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2024, për 12-mujorin e vitit 2024, janë shpenzuar në total **160, 003,290** lekë. Buxheti në tërësinë e tij për periudhën është realizuar në masën **97%**.

- **Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore**

Ky zë shpenzimesh është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën 105,819,795 lekë për paga si dhe 17,119,696 lekë për kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, rreth 99 % e fondit të planifikuar vjetor. Shpenzimet për paga janë kryer për punonjësit faktik në organikë dhe për punonjësit me kontratë. Për vitin 2024, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të miratuar

me vendimin nr. 39, datë 24.01.2024 është 14 punonjës. Aktualisht janë paguar 14 punonjës me kontratë për punën e kryer (6 orë) duke u trajtuar edhe me sigurime shoqërore.

- **Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime**

Për 12-mujorin 2024 shpenzimet në këtë zë janë **realizuar në vlerën 23,010,751** lekë nga 26,100,000 lekë që është plani. Në këtë zë përfshihen fondi për shpenzime operative në vlerën 25,700,000 lekë dhe 770,000 lekë janë transferuar te individët për pagesën e telefonisë celulare dhe pagesa nga fondi i veçantë. Në total ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën **89 %**, e planit total vjetor të shpenzimeve operative.

- **Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231)**

Buxheti i akorduar në këtë zë shpenzimesh për vitin buxhetor 2024 ishte 15,800,000 mijë lekë. Në zbatim të aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 fondi për investime u pakësua me 2,000,000. Për vitin 2024 realizimi faktik i shpenzimeve kapitale është 100% ndërsa ai financiar 97.2 % . Kjo diferencë është rezultat i kursimit të fondeve si rezultat i prokurimeve.

XIV.2. TË ARDHURAT DYTËSORE

Këto të ardhura realizohen në zbatim të VKM nr. 93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2024 janë arkëtuar në total **140,450** lekë, nga të cilat:

1. Nga kërkesat studimore janë arkëtuar në vlerën 59,375 lekë;
2. Nga kërkesat individuale janë arkëtuar në vlerën 81,075 lekë.

Të ardhurat e krijuara si më sipër derdhen totalisht në buxhetin e shtetit në kërkesë të vendimit të sipërcituar.

XIV.3. GRANTI I FINANCUAR NGA KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR

Nga granti i financiar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin "Mbështetja e drejtësisë tranzitore dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri" është arkëtuar vlera **1,046,902** lekë.

Kjo vlerë do të mbulojë/ka mbuluar shpenzimet për pagesën e pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të koordinatorit të projektit.

Për periudhën raportuese janë shpenzuar në total 298,000 lekë, në zërin shpenzime për paga.

XIV.4. PROKURIMET

Në funksion të veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2024, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në bazë të buxhetit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Autoritetin, për vitin 2024, në fillim të vitit është hartuar regjistri i parashikimeve për vitin 2024, në të cilin janë parashikuar procedurat e prokurimit për shërbime e mallra të domosdoshme dhe të nevojshme për veprimtarinë e institucionit.

Janë zhvilluar një pjesë e konsiderueshme e procedurave të prokurimit, të parashikuara në Regjistrin e parashikimeve të vitit 2024 është realizuar në masën 90 %. Procedura të rëndësishme të kryera gjatë vitit 2024 janë:

- realizimi i procedurës së skanimit të dokumenteve arkivore, një element shumë i rëndësishëm në migrimin e të dhënave në softin e arkivit;
- realizimi i marrëveshjes kuadër për botimin e librave: Botimet e ndryshme në kuadër të Marrëveshjes Kuadër të lidhur që në vitin 2023.
- sigurimi i Kartotekës si një pajisje e rëndësishme për arkivin e Autoritetit e cila shton elementet e kërkimit duke e rritur dhe përmirësuar sasinë dhe cilësinë e kërkimit arkivor.

Një tjetër procedurë prokurimi e rëndësishme e realizuar gjatë vitit 2024 është “Blerja dhe instalimi i pajisjeve audiovizuale” konkretisht: (i) Sistemit *e-Conference* në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit i përbërë nga 6 terminale *paperless*, 1 kompjuter kontrolli dhe “*rack*”-u ku bëjnë pjesë të gjithë aksesoret e tjerë mbështetës:(ii) Sistemit *e-Studim* i cili do të përdoret nga studiuesit, gazetarët dhe gjithë të interesuarit për të konsultuar në ambientet e Autoritetit materialet në formë digjitale.

Një vend jo pak të rëndësishëm në prokurimet e vitit 2024 zë dhe prokurimi i komponentëve/materialeve në funksion të realizimit të aktiviteteve (konferenca, takime me palët e interesit, aktivitete e kujtesës, ëorkshope etj.).

Vlen të përmendet që të gjitha procedurat e prokuruar, janë kryer në mënyrë transparente dhe me integritet të plotë nga njësitë e prokurimit, komisionet e vlerësimit të ofertave, komisionet e shqyrtimit të ankesave dhe të marrjes në dorëzim.

Përkthyer në shifra planifikimi i regjistrin të parashikimeve të Autoritetit dhe realizimi i tij për vitin 2024 në vlerën 30,757.1 mijë lekë me një realizim vjetor në vlerën prej 28,660 mijë lekë ose 90 %.

XV. KALLËZIMET PENALE DHE PROCESET GJYQËSORE, KU INSTITUCIONI KA QENË PALË NË PROCES

Më poshtë renditen të detajuara çështjet gjyqësore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në proceset gjyqësore, ku institucioni ka qenë palë në proces për vitin 2024.

Nr.	Paditës	Faza e procesit	Komente
1		Çështje gjyqësore në proces në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë	Paditësi i përfaqësuar nga avokati i tij, ka kërkuar shfuqizimin e pjesshëm të vendimeve të Autoritetit nr. 648, datë 02.11.2023 dhe nr. 719, dt. 15.12.2023, përsa i përket pjesës me përmbajtjen: “ <i>Shtetasi ... nuk rezulton të ketë qenë bashkëpunëtor apo i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, dhe as iurvejuar, por figuron në një çështje gjyqësore (penale) me detyrën (cilësinë) e prokurorit në rrethin e Tiranës në vitin 1987 për akuzën që përfshin ekzekutimin me vdekje, tradhti ndaj atdheut. Kjo është pafajësuar dhe si e tillë konsiderohet</i>

			<i>vepër penale politike, vendim i cili iu dërgua kërkuesit</i>”. Në seancën e datës 23.12.2024, kjo çështje u bashkua me një çështje tjetër me po të njëjtat palë ndërgjyqëse, por me objekte të ndryshme (objekti i çështjes tjetër ishte: <i>Shfuqizimi pjesërisht i aktit administrativ, vendimit nr. 7, datë 12.09.2023, deklasifikuar me vendim datë 03.01.2024, pika 3, e dispozitivit të vendimit të Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me përmbajtje –“Figuron në një çështje gjyqësore (penale) të arshivuar në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të administruar nga Autoriteti, në detyrën (cilësinë) e Prokurorit në rrethin e Tiranës, në vitin 1987, për akuzën, “Tradhti ndaj atdheut”, vepër penale e parashikuar nga neni 47/1 i Kodit Penal, në kreun, ‘Krime kundër shtetit’, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë 30.9.1991, ‘Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë’, të ndryshuar dhe hyjnë në fushën e veprimit të ligjit 45/2015, ‘Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë’”).</i> Në seancën gjyqësore të datës 25.02.2025, gjykata vendosi që të pranojë pretendimet e palës paditëse, duke vendosur kështu pra shfuqizimin e pjesëve të kërkuara të vendimeve.
4	E.P.	Çështje civile në proces në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Civile	Padi e ngritur prej shtetasit E.P., i përfaqësuar dhe me av. B.A., me objekt: <i>“1. Detyrimin e palës së paditur të më paguaj 2 (dy) paga bashkë me sigurimet shoqërore e shëndetësore nga puna e kryer për periudhën (janar-shkurt 2024) sipas nenit 116 të Kodit të Punës.</i> <i>2. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 1 (një) page mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, parashikuar nga neni 144 i Kodit të Punës.</i> <i>3. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 2 (dy) pagave mujore për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, sipas nenit 144 i Kodit të Punës.</i> <i>4. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën e 12 (dymbëdhjetë) pagave mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar të marrëdhënies së punës, sipas nenit 155 të Kodit të Punës.</i> <i>5. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë në masën 21(njëzet e një) ditë të lejes vjetore të pa konsumuar, që buron nga kontrata individuale e punës, sipas nenit 94 të Kodit të Punës.</i> <i>6. Detyrimin e palës së paditur të më dëmshpërblejë me 1 (një) pagë mujore të lejes vjetore të pa konsumuar që buron nga marrëdhëniet e punës të cilat kanë hyrë në heshtje me afat të pa caktuar.</i>

			<i>7. Detyrimin e palës së paditur të paguaj shpenzimet gjyqësore, noteriale dhe të avokatisë.”</i> Çështja është në shqyrtim, teksa janë zhvilluar deri më tani 2 seanca, një përgatitore dhe një gjyqësore, ndërsa më datë 19.03.2025 është seanca gjyqësore e radhës.
--	--	--	--